

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7784 E martë 5 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Nuk e di pse kur e hapa kapakun e shpirtit të tij më doli si libër, një libër i mocëm dhe me fletë të vyshkura si gjetet në vjeshtë... Nën rreshtat ...
Vijon në faqet 20-21

Nga PËRPARIM KABO
Duke lexuar shpirtin pergamen të Skënder Sherifit...!


Opinion *i* **Ditës**
Kur interesat e ekonomisë kombëtare preken, kryetari i shtetit, në frymën e Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 11, pika 2 e saj, për mbrojtjen me ligj ...
Vijon në faqet 21

Nga FATOS ÇOÇOLI
Kështu tenderohet vetëm në Zimbabve!




Erdogan dhe Papulias i japin pjata argjendi
Nga rakia e Vuçiqit te rubini i Ivanovit, ja lista e dhuratave që ka marrë Edi Rama

Lista me 183 dhurata, nga Joe Biden mori një orë. Ironia, Hashim Thaçi i dha hartën e Kosovës në gur
Në një intervistë televizive në shtator 2018, kryeministri Edi Rama u ankua se praktika e regjistrimit të dhuratave të çmuara nga dinjtarë të huaj ka munguar përpara se ai të vinte në krye të ekzekutivit në vitin 2013. "Kur u bëra kryeministër në mesin e Kryeministrisë nuk kishte asnjë dhuratë. Për herë të parë Kryeministria ka ...
Në faqen 4

INSTITUTI I SIGURIMEVE: SI TE KERKONI RILLOGARITJE TE MASES SE PERFITIMIT PROCEDURA, HAPAT PER TE KERKUAR RRITJE PENSIONI

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë të moshuarit që pretendojnë më shumë para. Aplikimi në portalin "E-Albania" dhe lista e gjatë e vërtetimeve të nevojshme



(Në foto) Pensionistë (foto ilustruese) Në faqen 11

ARSIMI I LARTE
Pedagogët në grevë, Albin Kurti përkrah studentëve: Fitoret vijnë nga qëndresa
Në faqen 10

OPOZITA
Malltezi: 30 qershor, do mbahen 2 zgjedhje. Kryemadhi: Protesta pa flamuj partiakë
Në faqen 2

KUSH S'PAGUAN FATURAT
Të varfërve nuk do u priten dritat nëse temperaturat do shkojnë -15 gradë
Në faqen 5

HORROR NE KAVAJE
Përdhunimi i të miturës, gjykata lë në burg 7 djemtë, ç'thonë banorët
Në faqen 7

GATI BYROJA E HETIMIT



Në Tiranë prokurorja kroate që futi në burg Sanaderin. Do rrijë 2 vjet në SPAK
Në faqen 8

Fituesit në portalin "Infermierë për Shqipërinë". Sa pikë ka marrë secili
Emrat, infermierët që kaluan testin në rrethe
Datat dhe oraret, faza e dytë në Lezhë, Elbasan, Berat dhe Vlorë

NGA VOLTIZA DURO
Të gjithë ata që kanë aplikuar për një vend pune në portalin "Infermierë për Shqipërinë", tashmë mund të njihen me pikët që kanë mundur të grumbullojnë. "Gazeta Shqiptare" publikon sot emrat e 600 fituesve për



4 qarqe, përkatësisht atë të Vlorës, Beratit, Elbasanit e Lezhës. Gjithashtu, zbardhen edhe datat e testimit të kandidatëve që kanë kaluar fazën e parë. Respektivisht janë 135 fitues në fazën e parë për Qarkun e Vlorës, 93 kandidatë fitues për Qarkun e Beratit...
Në faqet 12-13

PROTESTAT INTERVISTA

Anëtari i kryesisë: Largimi i Ramës, çështje ditësh, PD të bëhet njësh me qytetarët

Skenari, Malltezi: Me 30 qershor, do bëhen dy palë zgjedhje

"Pushteti në duart e kriminelëve, jo të socialistëve"

Valentina Madani

Jamarbër Malltezi, anëtar i kryesisë së PD-së ka bindjen e plotë se protesta e 16 shkurtit do të rrëzojë nga pushteti Edi Ramën. Malltezi beson se më 30 qershor shqiptarët do të votojnë për dy palë zgjedhesh, ato lokale dhe parlamentare. Malltezi thotë për "Gazeta Shqiptare" se largimi i kryeministrit është çështje ditësh, ndërsa PD-së i kërkohet që të bëhet njësh me qytetarët, duke i dëgjuar dhe adaptuar qëndrimet sipas nevojave të kohës. Z.Malltezi paralajmëron se: "Edhe atëherë regjimi komunist i kishte kapur të gjitha pushtetet, por përballja popullore i tregoi vendin. Partia Demokratike do të vijë në pushtet ngjashëm më 1992..."

Z.Malltezi, opozita ka ftuar qytetarët në një protestë kundër qeverisë më 16 shkurt. Çfarë do të ndodhë atë ditë...?

Opozita po bashkon qëndrimin e saj me vokacionin e qytetarëve. Po i mbështet qytetarët që përballen me arrogancën e hajdutëve të qeverisë dhe po nis stinën e protestave në bashkëpunim me qytetarët e thjeshtë. Më 16 shkurt, ne ftojmë çdo qytetar të nëpërkëmbur që të protestojë për të drejtat e veta, të protestojë e t'i dëgjojnë zëri dhe shqetësimi. Më 16 shkurt, uragani njerëzor do kthejë në pluhur fasadën e qeverisjes.

Çfarë udhëzimesh po ju jepni qytetarëve gjatë takimeve që po zhvillojnë deputetët dhe zyrtarët e lartë të PD-së?

Ejani dhe tregojini vendin atij që ka mbjellë trishtim në këtë vend të bekuar, atij që po largon 400 mijë qytetarë sikur të ketë rënë kolera. A po ju shijon shëndetësinë falas? A janë ushqimet më të lira? A ka hapur 300 mijë vende pune apo i përzuri? A di të thuasht një



Jamarbër Malltezi, anëtar i kryesisë së PD-së

premtim të vetëm që ka mbajtur Edi Rama? Padyshim që Rama është i rënë politikisht, ai nuk po prodhon dot më asgjë të re dhe po mban peng vendin. Rama është lakuriq, por (ndryshe nga mbreti i Andersenit që u tërhoq i turpëruar) po këmbëngul se ka petka shumë të bukura, të cilat nuk ia shquan dot njeri, pasi nuk qenëkëshin aq të mençur sa ai.

Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të PD-së, z.Basha kërko mobilizimin e të gjithë demokratëve për të nisur një sezon protestash, të cilat do të kulmojnë me largimin e Edi Ramës. Sa të mundur e shikoni ju këtë?

Edi Rama, në fakt është

dhe përdhunuesit në grup dhe jo PS-ja. Strukturat e PS-së janë atrofizuar dhe inekzistente, anëtarët e PS-së janë të turpëruar para kësaj gjendje. Na del si detyrë historike të nisim stinën e protestave për t'i dhënë dritën njeriut të thjeshtë, përfshi anëtarit të PS-së për t'u shprehur haptazi dhe qartë. Ka një pakënaqësi totale me qeverinë e tashme. Banorët e Unazës së Re e kishin votuar, pasi ju ishte premtuar legalizim falas, por u përballën me vjedhje 40 milionë euro për 2 km rrugë sekondare për kompani fantazëm; studentët e inxhinierisë u bënë katalizator i një pakënaqësie totale ndaj qeverisë harbutë dhe ligjit anor-

AKUZA

"Pushteti në Shqipëri e ka krimi i organizuar, trafikantët e drogës dhe përdhunuesit në grup dhe jo PS-ja. Strukturat e PS-së janë atrofizuar dhe inekzistente, anëtarët e PS-së janë të turpëruar para kësaj gjendje. Na del si detyrë historike të nisim stinën e protestave për t'i dhënë dritën njeriut të thjeshtë, përfshi anëtarit të PS për t'u shprehur haptazi dhe qartë", tha z.Malltezi.

deligjitimuar, pasi është kapur në përgjimet e bandave të tij që kanë blerë zgjedhjet me para dhe kërcënime. Pushtetin në Shqipëri e ka krimi i organizuar, trafikantët e drogës

mal; fermerët e Korçës po hedhin mollët në lumë pasi nuk ju shiten, pra kjo qeveri është e fasadës dhe një grupi oligarkësh që ndajnë paratë publike, por jo me qytetarëve. Largimi i Ramës

ZGJEDHJET

"Ne besojmë që do mbahen zgjedhjet vendore dhe parlamentare bashkë. Raporti i OSCE na tregoi se 20% e votave ishin blerë. Përgjimet e Gjushit me Durrës, Ndokës në Lezhë, Bajrave me Bushatin në Shkodër, Habillajve në Vlorë, Ballilit në Sarandë etj.", deklaroi anëtar i kryesisë së PD-së.

është çështje ditësh nëse PD do shkrihet me qytetarët, do gjejë emërues të përbashkët me shqetësimet e tyre dhe do ofrojë forumin e duhur për t'u shprehur lirshëm.

OPOZITA

Opozita po bashkon qëndrimin e saj me vokacionin e qytetarëve. Po i mbështet qytetarët që përballen me arrogancën e hajdutëve të qeverisë dhe po nis stinën e protestave në bashkëpunim me qytetarët e thjeshtë. Më 16 shkurt, ne ftojmë çdo qytetar të nëpërkëmbur që të protestojë për të drejtat e veta, të protestojë e t'i dëgjojnë zëri dhe shqetësimi.

Si e shikoni, ekipin e ri të z. Basha të dalë nga zgjedhjet e brendshme në PD, pjesë e të cilit jeni edhe ju vetë? Pjesa më e madhe e sekretariateve përbëhet nga njerëz teknikë. A frymëzohet ky ekip i ri, sipas jush?

Qoftë kryesia që ishte dhe qoftë kjo e reja kanë qenë shumë forume të mira. Kryesia e re është finalizim i një procesi statutor. Ka një ndërthurje si të personalitetve teknikë edhe atyre politike. Është pozitiv padysim, ndonëse është gjynah që mbeten jashtë disa personalitete të spikatura politike.

Cila është përgjigja juaj për kritikë e kryesisë së re të PD-së?



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, duke me qytetarët e Lezhës

Kryesia e PD-së ishte shumë e mirë dhe është shumë e mirë. Pati një proces interesant dhe shumë demokratik për zgjedhjen e 15 anëtarëve të kryesisë nga lista prej 50 personalitetesh nga Këshilli Kombëtar dhe kjo ishte pozitive. Por, puna e forumeve tani do fillojë të duket me aktivizimin më të madh me anëtarët dhe qytetarët.

Pas zgjedhjes së kryesisë së re, ish-nënkryetarija e PD-së, Jozefina Topalli hodhi kritika në drejtim të Lulzim Bashës, duke e cilësuar lidhshin e ri si pa identitet. Si i vlerësoni këto kritika të ish-funk-

dhënat apo të pranojë debat për shumë afera të rënda korruptive si psh., vjedhja e 178 milionë eurove për 3 djeqës të pakërkuar dhe të pacertifikuar. Institucionet e tjera janë kapur nga qeveria dhe nuk kemi asnjë institucion të pavarur. Pra, prezencën në Kuvend ndonëse e domosdoshme në një demokraci këtu po kthehet në një fasadë, pasi nuk respektohet asnjë normë dhe asnjë institucion.

Sa të mundshme i shikoni zgjedhjet e parakohshme parlamentare?

Shumë të mundshme. Ne besojmë që do mbahen zgjedhjet vendore dhe parlamentare bashkë. Raporti i OSCE na tregoi se 20% e votave ishin blerë. Përgjimet e Gjushit me Avdyllët në Durrës, Ndokës në Lezhë, Bajrave me Bushatin në Shkodër, Habillajve në Vlorë, Ballilit në Sarandë etj., kanë vërtetuar katërciperisht blerjen e zgjedhjeve dhe pretendimin se nuk ka zgjedhje të lira me Edi Ramën. Edhe personazhet e keqpërdorur nga qeveria në Bruksel nuk guxojnë dot më të pretendojnë se kjo qeveri është e zgjedhur në mënyrë demokratike.

Si do të vijë PD-ja në pushtet dhe a është ajo gati të qeverisë ndryshe shqiptarët?

Partia Demokratike do të vijë në pushtet ngjashëm më 1992. Duke u bërë njësh me qytetarët, duke i dëgjuar dhe adaptuar qëndrimet sipas nevojave të kohës. Edhe atëherë regjimi komunist i kishte kapur të gjitha pushtetet, por përballja popullore i tregoi vendin. Z.Basha ka filluar një tur takimesh me qytetarët në shumë qytete të vendit. Kjo është një fillim i mbarë që premtim për një qeverisje normale në një vend evropian.



Kreu i PD u shpalo lezhjanëve prioritetet kryesore të PD, punësimin dhe uljen e taksave

Basha: Qeveri tranzitore dhe zgjedhje të parakohshme

"Pas hekurave, ata që grabitën pronat publike"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, u bëri dje thirrje qytetarëve të Lezhës dhe Laçit që të marrin pjesë në protestën e 16 shkurtit për rrëzimin e qeverisë "Rama". Si në 2 mars të 1444, z.Basha i ftoi lezhjanët për një besëlidhje. Kësaj here një besëlidhje, që ai shprehet se shërben për të rrëzuar qeverinë, që sipas kreut të demokratëve, përfaqëson interesat e kriminit dhe jo të shqiptarëve. Me lezhjanët, Basha diskutoi edhe mënyrën sesi duhet të largohet Edi Rama. Përpara vendvarrimit të Skënderbeut, Basha deklaroi se një popull që nuk nxjerr mësim nga historia do e pësojë, ndaj u bëri thirrje atyre që në 16 shkurt të marrin në dorë fatet e tyre: "Ai nuk është kryeministri juaj. Ka ardhur në pushtet nga pakti me ndokët dhe shullazët. Merrni në dorë fatet tuaja". Z.Basha teksoi takimin e vogël në Lezhë, u rikujtoi se me të ardhur në pushtet, i gjithë biznesi i vogël me nën 140 milionë lekë të vjetra në vit do të përjashtohet nga TVSH-ja, taksa do të jetë 0.5% e xhiros vjetore me. "Shëndetësi jo, shkolla jo. 10 shkolla janë mbyllur vetëm në Lezhë. Ndhimë ekonomike për ata që nuk kanë bukë të hanë jo, vjedhje me faturën e energjisë po. Nafta, çmimi më i lartë. Ky është prodhimi i vetëm i kësaj qeverie dhe i këtij kryeministri. Arsyja është se nuk ndjen asnjë përgjegjësi ndaj jush se ju votën nuk ia keni dhënë. Ai votën e ka vjedhur dhe e ka marrë me banditë dhe kriminelë", tha z.Basha. Zgjidhjen për daljen e vendit nga kriza, banorëve të Lezhës dhe biznesit të vogël, Basha iu tha se e garanton plani ekonomik i Partisë Demokratike. "I gjithë biznesi i vogël nën 140 milionë lekë të vjetra në vit, do të përjashtohet nga TVSH, taksa do të jetë 0.5% e xhiros vjetore me një pullë të vendosur këtu tek vitrina jote. Do të ulim energjinë deri në 40%", u shpreh z.Basha. Në një tjetër takim me peshkatarët, Basha premtoi se pas ardhjes në pushtet, qeveria e tij nuk do lejojë asnjë ligj që shkon në kah të kundërt të interesave të tyre. Z.Basha u ndal edhe në Laç po për të ftuar banorët t'i bashkohen në protestën e 16 shkurtit, për t'i dhënë vendit një zgjidhje politike që



DEKLARATA
Kreu i PD-së, Lulzim Basha, akuzoi dje kryeministrin Rama se kërcënon studentët me humbjen e vitit të ri shkollor. "I kapur nga paniku, Rama kërcënon studentët me humbjen e vitit shkollor. Me mirënjohje për shembullin e tyre, opozita i siguron studentët që viti akademik nuk do të humbasë, duke iu bërë thirrje të mos kenë frikë. Kausa e tyre është e drejtë! Mbarë shoqëria është me ta! 16 shkurt", tha z.Basha.

Kryemadhi: Protesta e qytetarëve, 16 shkurti pa flamuj partiakë

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, takoi dje mbështetës të forcës politike që ajo drejton në njësinë administrative numër 8 në Tiranë. Kryemadhi tha se në 16 shkurt duhet të jenë të gjithë që të protestojnë, sepse nuk është një protestë e partive, por është një protestë për shqiptarët. "Data 16 shkurt është një datë që opozita e ka lënë për një protestë për të gjithë Shqipërinë. Nuk duhet të dalin për opozitën, por të dalin për hallin e tyre. Unë shqiptarët i shikoj më të lodhur seç kanë qenë 5 vjet më parë, më të rraskapitur se 5 vjet më parë. Sot të gjithë shikojnë mundësi të vetme largimin nga Shqipëria. Prandaj 16 shkurti do të jetë një datë, ku të gjithë do të mbledhen për të protestuar për hallin e tij. Prandaj në 16 shkurt ju do të jeni me gjithë familjet. Fjalime nuk do të ketë, sepse njerëzit nuk kanë nevojë për fjalë, por kanë nevojë për reagim. Ndryshimi nuk është për të hequr një kryeministër dhe për të vënë një tjetër. Protesta e 16 shkurtit nuk është një protestë politike dhe nuk do ketë flamuj të partive, se nuk është e partive, është një protestë e të gjithëve", tha zj.Kryemadhi.



"Të dhënat personale, në rrezik"

Berisha: Regjistrat e Gjendjes Civile hidhen në internet

Ish-kryeministri Sali Berisha dha dje alarmin se qytetarëve shqiptarë u rrezikohet privatësia. Duke iu referuar mesazhit të një qytetari dixhital, Berisha shprehet se të dhënat janë nxjerrë në pazar. Qytetari dixhital tregon se të dhënat e gjendjes civile mund të mësohen nga të gjithë në sajë të disa mënyrave të thjeshta që japin akses në sistemin. Z.Berisha publikoi mesazhin: "Gjatë një kërkimi të thjeshtë në internet, vura re se sa e thjeshtë është të aksesosh në të dhënat personale të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Nëse në YouTube kërkoni 'Regjistri i Gjendjes Civile', janë disa video ku tregohet se si mund ta shkarkosh e të kesh akses në të dhënat personale të çdokujt. Kjo tregon se sa të pasigurta



janë të dhënat tona. Çdo person mund ta bëjë një kërkim të tillë dhe mund të ketë akses tek këto të dhëna, që duhet të jenë në mënyrë të rreptë diskrete. Po ju çoj linkun e videos në YouTube: https://www.youtube.com/watch?v=FLYP7fK6_DE, po ashtu edhe linkun se ku mund të shkarkohet Regjistri i Gjendjes Civile: <http://gjendjაცivile.blogspot.com/>

... /shkarko-gjendjen-civile... Privatësia dhe të dhënat personale, në rrezik. Ky informacion mund të përdoret nga kushdo për arsye dhe qëllime të ndryshme, që mund të dëmtojnë qytetarët nga persona dashakeq. Shpresoj që ta bëni publik këtë skandal dhe rast të paprecedentë në çështjen e sigurisë së të dhënave personale".

Protesta, banorët e Rrogozhinës bllokajnë autostradën: Rama ik!

Opozita e bashkuar organizoi dje protestën e radhës të rreth-rrotullimit i Rrogozhinës, duke bllokuar autostradën në të dyja anët e saj, pranë rreth-rrotullimit të Rrogozhinës. Në krye të protestës ishte deputetja Orjona Pampuri, ndërsa demokratët deklaruan se për shkak të kësaj proteste u bllokua edhe eskorta e kryeministrit, të cilit iu desh që të devijonte rrugë. Ata deklaruan se po protestojnë për rritjen e çmimeve dhe mungesën e punësimit si dhe largimin e të rinjve, që nuk e shohin perspektivën në Shqipëri. "Ne protestojmë për studentët, për punën e naftës, sepse është shtrënjtë. Kanalet vaditëse që nuk janë pastruar. Edi Rama duhet të largohet sa më parë", - tha një protestues.



synon rikthimin e demokracisë. Sipas kreut të demokratëve, pa rrëzimin e Edi Ramës, Shqipëria rrezikon sërish moshapijen e negociatave me Bashkimin Europian. Në rrugën kryesore të Laçit pati një vërshim qytetarësh, të cilët nxituan për t'i shtrënguar dorën liderit opozitar, Lulzim Basha. Kurbinasit i kishin rezervuar një pritje ndryshe kryedemokratit: "Shoh që qenka kthyer në miting takimi. Kjo zonë ka

qenë në shënjestër të bandave të Edi Ramës. Spitali juaj është si në Luftën e Parë Botërore. PD-ja do iu dalë zot", deklaroi kreu i PD-së. Nga Kurbinia, ftesa për pjesëmarrje në protestë nuk ishte vetëm për demokratët, por edhe për socialistët: "Socialistët e di që janë të zhgënjyer: Bëhuni bashkë më 16 shkurt me ne". Në Laç, Basha u zotua se shkelësit e ligjit që kanë grabitur pronën e shqiptarëve do të shkojnë për-

para ligjit. "Ne i kemi planet dhe zgjidhjet për ju. Do t'ua marrim pasuritë deri në qindarkën e fundit oligarkëve dhe do t'ua kthejmë juve. Çdokush që ka shkelur ligjin do të shkojë atje ku e ka vendin, para drejtësisë dhe pra pa hekurave, duke filluar me të parin e qeverisë", - u shpreh kreu i PD-së. Ndërkohë, qytetarët kërkuan nga Basha që protesta e opozitës të zgjasë deri në largimin e kryeministrit.

QEVERIA DHURATAT

Zbulohet lista e dhuratave të çmuara që i janë bërë kryeministrit në 6 vjet qeverisje

Nga rakia e Vuçiçit te rubini i Ivanovit, 183 dhuratat që ka marrë Rama

Presidenti i Maqedonisë i ka dhuruar një gur rubini në pjatë



Në një intervistë televizive në shtator 2018, kryeministri Edi Rama u ankua se praktika e regjistrimit të dhuratave të çmuara nga dinjitarë të huaj ka munguar përpara se ai të vinte në krye të ekzekutivit në vitin 2013. "Kur u bëra kryeministër në godinën e Kryeministrit nuk kishte asnjë dhuratë. Për herë të parë Kryeministria ka një regjistër të dhuratave dhe ka dhurata të çmuara, të cilat s'i kam marrë me vete në shtëpi. Por i kam lënë aty" do të deklaronte Rama. Duke marrë shtysë nga deklarata e kryeministrit, BIRN iu drejtua Këshillit të Ministrave me një kërkesë për një kopje të regjistrit të dhuratave që mbante ky institucion. Pesë muaj më vonë, pas një rekomandimi nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, Këshilli i Ministrave u përgjigj pozitivisht, duke dërguar një dokument ku listoheshin dhe përshkruheshin 183 dhuratat e çmuara të pranuar nga kryeministri Edi Rama në periudhën shtator 2013 - dhjetor 2018. Lista e dhuratave të marra nga kryeministri Edi Rama gjatë 6 viteve të fundit nuk përfshin kafshë ekzotike dhe as puru kubane; megjithatë, aty nuk mungojnë objektet e çmuara, sendet e pazakonta dhe vëmendja ndaj së shkuarës së kreut të qeverisë si artist. Kjo listë përfshin 43 libra, 19 pjata porcelani apo argjendi, 10 piktura, medalje dhe medaljone, qypa, qilima, stilolapsa, stilografë dhe shpata. Edhe pse numri i dhuratave të shkëmbyera nuk është domosdoshmërisht tregues i marrëdhënieve bilaterale, lista e vendeve që kanë qenë më bujare ndaj kryeministrit shqiptar kryesohet nga Italia me 16 dhurata, Gjermani me 15 dhe Franca me 13, të ndjekura nga Turqia dhe Bullgaria me respektivisht 11 dhe 10 dhurata.



Një nga dhuratat për kryeministrin Edi Rama

SHPATAT

Në gusht 2018, gjatë një vizite në Tiranë, Princi Saudit Sultan bin Selman bin Abdulaziz Al-Saud, i dhuroi Edi Ramës një shpatë të vogël. Një shpatë e vogël me ngjyrë të verdhë iu dhurua Ramës edhe në 2018 nga zv. presidentja bullgare, Ilirjana Jetova.

VIKTOR PONTA

Në 18 shkurt 2016, ish-kryeministri rumun, Viktor Ponta i dhuroi homologut të tij shqiptar një "shportë me produkte vendase, bio." Një dhuratë e tillë do të ishte pak e vështirë për t'u arkivuar në Kryeministri.

DHURATAT E DISA PREJ PERSONALITETEVE MË TË RËNDËSISHME

- Presidenti Bullgarisë, Z. Rosen Plevneliev - Pjatë bakri, dizenuar me kalë
- Presidenti i Republikës së Maqedonisë Geroqe Ivanov - Gur rubini në pllakë mermeri
- Ministri i Jashtëm Turk Ahmet Davutoglu - Libër i Ahmet Davutoglu në shqip
- Ministria e Jashtme e Italisë, Emma Bonino - Një senduk prej druri
- Zv.kryeministri dhe ministri i Jashtëm i Greqisë - Pjatë argjendi
- Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi - Harta e Kosovës e punuar në gur
- Kryeministri i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan - Një pjatë me kapak argjendi
- Presidenti Greqisë, Karolos Papoulias - Pjatë argjendi me doreza
- Kryetari i parlamentit të Maqedonisë, Z. Trajko Veljanovski - Maskë prej ari, 2 copë
- Patriarku i Serbisë, Irenue - Ikonë
- Kryepeshkopi i Shqipërisë, Anastas Janullatos - Disa libra dhe një shqiponjë
- Presidenti i UEFA Michel Platini - Suvenir, orë në glob
- Presidenti Italian, Z. Gergio Napolitano - Një gotë prej kristali me stemën e Republikës së Shqipërisë
- Papa Francësi - Pllakë
- MPJ Gjerman, Frank Walter Steinmeier - Pikturë me futbollist
- Kryetari Parlamentit Çek, Jan Hamacek - Butona këmbishe
- Angela Merkel, Kancelarja Gjermane - Pikturë me akuaerale
- Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan - Qyp porcelani 60 cm me senduk
- Aleksandër Vuçiç - Pikturë
- Presidenti i Francës, Francois Hollande - Pjatë argjendi me stemën e Francës dhe gotë me stemën e Francës
- Bartolomeu I, Patriark Ekumenik i Kostashtadopolit - Tabaka si argjend
- MPJ Ivica Dajç - Qilim
- Sekretari Amerikan i Shtetit John Kerry - Kuti zbukurimi, limited edition
- Abdullah II, Mbreti i Jordanisë - Set stilograf
- Joe Biden, Zv. President - Punim në xham simbol i varrezave ushtarake dhe orë tavoline

Librat dhe medaljet, peshqeshet më të shpeshta që bëjnë të huajt

Gati 1/4 e 183 dhuratave të marra nga kryeministri Edi Rama gjatë viteve 2013-2018 përbëhet nga libra, me tema dhe autorë të ndryshëm, por që mund të përmblidhen në disa kategori kryesore, ku përfshihen biografi dhe libra me autorë personalitete të shquara, libra mbi marrëdhëniet dypalëshe midis Shqipërisë dhe vendit që përfaqëson dinjitari i huaj, si dhe libra që kanë si temë kulturën apo bukuritë natyrore të vendeve të ndryshme. Dhuruesi më i madh i librave për kryeministrin Edi Rama ka qenë Princi Ghazi i Jordanisë në një vizitë zyrtare në Aqabë në qershor 2018. Librat e dhuruar nga Princi Ghazi për Ramën kanë si temë botën dhe fenë Islame, si dhe mënyrat se si një vend mund t'u përgjigjet ekstremistëve fetarë. Një kategori e veçantë në librat që ka marrë si du-



ratë Edi Rama përbëjnë dhe biografitë apo veprat e personaliteteve të ndryshme. Për shembull, në tetor 2013, ish-ministri i Jashtëm turk Ahmet Davutoglu i ka dhuruar kryeministrit shqiptar një botim të tij në shqip. Ngjashëm Patriarku i Moskës dhe Rusisë, Kirill i ka dhuruar Edi Ramës librin e tij "Freedom and Responsibility" - gjatë vizitës në Tiranë në

maj 2018. Bibliotekës së Këshillit të Ministrave nuk do t'i mungojë as biografia e Hashim Thaçit "New State, Modern Statesmen" - e shkruar nga Roger Boyes dhe Suzy Jagger, e cila ka ardhur me një dedikim nga presidenti i Kosovës. Libra biografikë i kanë dhuruar Ramës edhe Simeoni II i Bullgarisë si dhe sipërmarrjes spanjoll, Migel Fluxa, të cilin Rama e takoi në qershor 2018. Listës së dhuratave për kryeministrin shqiptar nuk i kanë munguar dhe medaljet, si për shembull ajo e dhuruar nga Hashim Thaçi në shkurt 2018, me rastin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Patriarku Kirill i Moskës dhe Rusisë i ka dhënë Ramës një medalje në nder të 45-vjetorit të shugurimit të tij, ndërsa kryebashkiaku i 'Maire de Moulins' në Francë i ka dhuruar medalje që paraqet Virgjëreshën e Mullirit.

stemën e Republikës. Kryeministri shqiptar ka marrë dy të tilla; një nga ish Presidenti i Senatit të Francës, Jean Pierre Bell në mars 2014 dhe një tjetër nga ish-presidenti Francois Hollande në nëntor 2014. Presidenti Austriak Heinz Fischer i ka dhuruar kryeministrit shqiptar një pjatë argjendi me simbolin e Theresias, ndërkohë ministri i Jashtëm grek, Nikos Kot-

zias një pjatë argjendi me vegël muzikore. Ndërkohë, Milan Stech, kryetari i Senatit të Republikës Çeke i ka dhuruar kryeministrit shqiptar dy kupa kristali Boheme me buzë me rreth ngjyrë ari.

PIKTURA PËR PIKTORIN

E kaluara e kryeministrit Rama si artist dhe pedagog arti duket se ka ndikuar; gjith-

ashtu, në përzgjedhjen e dhuratave që i kanë bërë personalitete dhe diplomatë të huaj. Në total gjatë viteve 2013-2018, Rama ka marrë si dhuratë 10 piktura dhe 1 ikonë nga personalitete të shquara si Kancelarja gjermane, Angela Merkel, homologu i tij serb, Aleksandër Vuçiç apo ish-ministri i Jashtëm gjerman, Frank Walter Steinmeier; i cili tani mban postin e p r e s i -

dentit të Gjermanisë dhe njihet për pasionin e tij për futbollin. Në vizitën në Shqipëri si ish-ministër i Jashtëm, ai i dhuroi kryeministrit shqiptar një pikturë futbollisti. Edhe Kancelarja gjermane, Angela Merkel i ka dhuruar Ramës një pikturë prej akuaerale gjatë së njëjtës vizite, por detajet mbi këtë veper arti mungojnë në përshkrimin e ofruar nga Këshilli i Ministrave. Piktura që iu dhurua nga homologu i tij Serb gjatë vizitës në Tiranë në maj 2015 është kataloguar me përshkrimin e thjeshtë "pikturë". Të njëjtin fat ka pasur dhe një veper arti e dhuruar nga Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi një vit më vonë. Kryeministri serb raportoi-

het t'i ketë dhuruar Ramës për ditëlindje edhe një shishe raki kumbulle gjatë një takimi në Paris në korrik 2016. Megjithatë, kjo dhuratë e çmuar për shpirtin ballkanas nuk gjendet në listën e dërguar nga Këshilli i Ministrave. Me gjasë do të ketë avulluar para arritur në zyrrë e protokollit. Pak më shumë vëmendje nga protokollu ka marrë një pikturë e dhuruar nga Norbert Kartmann, kryetari i parlamentit të landit gjerman të Hessenit, e përshkruar si 'luan dhe objekt me ngjyra të kuqe'. Ndërsa një dhuratë nga princi i kuorës së Abu Dhabi, Sheik Mohammed bin Zayed Al Nahun është përshkruar në mënyrë minimaliste si 'pikturë kal'.



Rregullorja e Entit të Energjisë, si do përfitojnë familjet në nevojë

Vendimi për faturat e energjisë, kriteret e reja për familjarët

Temperatura -15 gradë, OSHE s'ndërpret energjinë

Të gjitha familjet në nevojë që s'kanë mundësi të paguajnë në kohë faturat e energjisë elektrike, nuk do t'u ndërpritet më furnizimi me energji. Enti Rregullator i Energjisë ka miratuar Rregulloren mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë, ku përcakton të drejtat e familjeve në pamundësi ekonomike për të pasur energji, pavarësisht faktit nëse mund ta paguajnë atë në kohë ose jo. Ndërmjet të tjerave, kjo rregullore përcakton se furnizuesi me energji, në këtë rast OSHE, nuk mund të ndërprisë energjinë elektrike për këtë kategori, përveçse kur brenda 1 viti kalendarik, abonenti nuk ka pranuar asnjë nga programet apo planet e pagesës që i është ofruar nga furnizuesi, apo kur në 4 muajt e fundit ai nuk ka pranuar të paguajë energjinë elektrike sipas planit të rënë më parë dakord. Gjithashtu, klientëve në nevojë nuk do t'u ndërpritet ndër të tjera energjia elektrike edhe kur temperaturat ditore kapin nivelin e minus 15 gradëve celsius. Një përcaktim ky që nuk vlen shumë për rastin e Shqipërisë, pasi këto temperatura janë të rralla edhe për zonat më të ftohta të Shqipërisë.



ENERGJIA
Nuk mund të ndërpritet furnizimi me energji elektrike në ditët kur furnizuesi nuk realizon shërbimin për klientët në qendrat e kujdesit ndaj klientit, ose kur klienti është duke respektuar një plan pagese formale, ose kur klienti ka paraqitur një ankesë.



Mazhoranca rrëzon dekretin e Metës për ligjin e noterisë

Mazhoranca në Komisionin e Ligjeve rrëzoi dje dekretin e Presidentit të Republikës, Ilir Meta, me anë të të cilit ktheu për rishqyrtim në Kuvend ligjin "Për Noterinë". Ndërsa këshilltari i tij ligjor shpjegoi arsyet e kthimit të këtij ligji para Komisionit të Ligjeve, ato nuk gjetën dakordësinë as të Dhomës së Noterisë, as të drejtueses së misionit EURALIUS dhe as të mazhorancës. Agnes Bernhard, drejtuese e misionit EURALIUS u shpreh se ligji krijon balancën e duhur dhe se ndryshimet e bëra ishin të duhurat. "Ligji përpiqet të bëjë një balancë proporcionale të interesave të elementëve të ndryshëm dhe me besojmë se ky ligj arrin ta krijojë balancën e duhur. Pa qenë nevojta të futëshim shumë në teknikalitete, ne besojmë se ligji është në përputhje me standardet europiane", - tha ajo. Opozita nga ana e saj mbështeti argumentet e paraqitura nga presidenti, ndërsa mazhoranca vlerësoi se ligji ishte hartuar me mbështetjen e ndërkombëtarëve dhe se ishte i domosdoshëm për të disiplinuar shërbimin e noterisë. Me këtë argument, ata me shumicë votash rrëzuan dekretin e presidentit.



Kuvendi voton Besnik Mustafajn për Këshillin e RTSH-së

Pavarësisht konfliktit alitetit të debatit politik, mazhoranca dhe opozita janë të afta që të gjejnë mirëkuptim, kur bëhet fjalë për interesa të përbashkëta. Kështu, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në drejtimin e deputetes demokratike Albana Vokshi, miratoi me shumicë votash 3 kandidatët që do t'i shkojnë Kuvendit për të zgjedhur anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues të Radio-Televizionit Shqiptar. Mes tyre bie në sy edhe emri i ish-ministrit të Jashtëm në kohën e qeverisjes së PD-së dhe shkrimtarit, Besnik Mustafaj. Po ashtu, krahas tij komisioni ka zgjedhur edhe dy kandidatë tjerë: ato të Edmon Tullumanit dhe Helidon Halitit. Para se të votoonte, komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me nëntë kandidatët për në KDRTSH dhe konkretisht: Besnik Mustafajn, Anila Bishan, Helidon Halitit, Genc Tomçon, Arben Lagretan, Edmon Tullumanin, Kristaq Birdon, Ilir Gocin dhe Arian Pacon.

Ja rastet kur një familje mund t'i ndërpritet energjia elektrike

Furnizimi me energji elektrike për klientët në nevojë mund të ndërpritet në rastet kur klienti humb statusin e klientit në nevojë, si dhe kur ai nuk kontakton furnizuesin për të nënshkruar një marrëveshje për ta paguar energjinë elektrike që ka përdorur, bazuar në një plan pagesash të dakordësuar mes palëve. Po ashtu, kjo rregullore përcakton se klienti në nevojë nuk pajtohet me më shumë se një nga ofertat e planit të pagesave në përputhje me të ardhurat e tij, të ofruar



nga furnizuesi gjatë 12 muajve të fundit dhe kur ai nuk respekton planin e pagesës, të dakordësuar

më parë me furnizuesin ose nuk paguan një shumë të caktuar për më shumë se 4 muaj.

me më shumë se një nga ofertat e planit të pagesave në përputhje me të ardhurat e tij, të ofruar

nga furnizuesi gjatë 12 muajve të fundit dhe kur ai nuk respekton planin e pagesës, të dakordësuar

paguan për furnizimin me energji elektrike plotësisht ose pjesërisht, sikurse kërkohet në kontratën e energjisë elektrike, por detyrimi i tij i përgjithshëm ndaj furnizuesit nuk e tejkalon nivelin minimal të të ardhurave, ose në fundjavë, ose gjatë ditëve të pushimit, sikurse edhe në rastet e kushteve atmosferike me temperaturë ditore -15 gradë celsius.

TIRANË - Edmond Kollari, i cili ka qenë i akuzuar për aksidentin me pasojë vdekjen e 17-vjeçarit Ardit Gjoklaj në landfillin e Sharrës i ka shpëtuar dje një atentati me armë zjarri. Ngjarja është denoncuar nga vetë 43-vjeçari në policinë e Tiranës. Mësohet se mëngjesin e djeshëm, në rrugën "5 Maji" në kryeqytet është qëlluar me 5 plumba pistolette në drejtim të Kollarit, i cili po shkonte drejt banesës së tij. Ky i fundit i ka shpëtuar plumbave dhe ka telefonuar policinë për ndi-



Edmond Kollari u qëllua me armë zjarri afër banesës

Atentat shoferit të ekskavatorit që aksidentoi për vdekje Ardit Gjoklajn në landfillin e Sharrës

hmë. Gjatë dëshmisë së tij para bluve, 43-vjeçari ka deklaruar se kishte dalë për të blerë bukë dhe tekta po kthej në shtëpi është ndjekur nga një person që ka qëlluar disa herë në drejtim të tij, por fatmirësisht nuk ka mbetur i dëmtuar. Dyshohet se autori

ka pasur për qëllim ekzekutimin e 43-vjeçarit dhe pas të shtënave është larguar menjëherë duke humbur gjurmët. Ndërkaq, burime nga policia bënë me dije se "rreth orës 06:30 të mëngjesit në numrin e Emergjencave 112 ka ardhur një telefonatë

nga shtetasi E. K., 43 vjeç, i cili njofton se në rrugën "5 Maji", një person i paidentifikuar ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të tij e me pas është larguar. Shtetasi E. K., nuk ka pësuar lëndime. Shërbimet e policisë po punojnë për identifikimin

dhe kapjen e autorit". Dyskohet që ngjarja të ketë marrë shkas për hakmarrje. Kjo për faktin se Edmond Kollari është shoferi i ekskavatorit, i cili aksidentoi për vdekje 17-vjeçarin Ardit Gjoklaj në landfillin e Sharrës, ngjarje kjo e ndodhur më 7 gusht të 2016-ës. Prokuroria në atë kohë akuzoi Kollarin për aksidentin me vdekje, por gjykata e shpalli të pafajshëm pasi nuk gjeti prova. Policia thotë se po e heton ngjarjen e së hënës, por ende nuk ka një pistë të qartë.

Prokuroria: Dyshohen se pasuritë janë vendosur nga aktiviteti kriminal

Laboratori në Has, sekuestrohen pasuritë e "baronit" të drogës

Gjykata bllokoi resortin "Ador" në Rinas të Admir Hoxhës me sipërfaqe 3320 m² dhe një 'Audi'



Laboratori i heroinës në Brenog të Hasit

TIRANË

Gjykata e Krimeve të Rënda, me kërkesë të prokurorisë ka sekuestruar pasurinë e biznesmenit Admir Hoxha, i cili është konsideruar si "truri" i laboratorit të heroinës në Has dhe një prej baronëve të drogës. Burime zyrtare nga Prokuroria për Krime të Rënda dje bënë me dije se është vendosur masa e sigurimit personal pasuror dhe sekuestros preventivë për pasuritë e paluajtshme të shtetasit nën hetim Admir Hoxha. Bëhet fjalë për resortin "Ador" me sipërfaqe 3320 m², me katër kate bar restorant, parking dhe hotel, në Rinas Tiranë si dhe bllokimin e aseteve. Gjithashtu është vënë në sekuestro dhe automjeti tip "Audi" me targë AA111MP. Pasuritë e Admir Hoxhës dyshohet se janë vendosur nga të ardhurat e krijuara nga aktiviteti kriminal. Kërkesën e parashtruar prokurorët Vladimir Mara dhe Dritan Prençi mbështetur në bazën e neneve 274, 275, 276, të Kodit Penal dhe nenit 36 të Kodit të Procedurës Penale.

NJOFTIMI I PROKURORISË

Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal të vitit 2016, për kryerjen e veprave penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Trafikimi i narkotikëve", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal" parashtruar nga nenet 283, 283/a, 333/a dhe 334 i K. Penal, procedimin penal i regjistruar mbi bazën e akteve të referuar nga Komisarjati i Policisë Kavajë.

Nga aktet e administruar rezultuan se Prokuroria Kavajë me datë 14.11.2016 ka regjistruar procedimin penal për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", parashtruar nga neni 283 i K. Penal.

Nga aktet e referuara nga Shërbimi i Policisë Gjyqësore të Komisarjati të Policisë Kavajë kanë rezultuar të dhëna për një grup personash të paidentifikuar, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin dyshohet se trafikonin lëndë

narkotike nga Shqipëria në drejtim të Italisë, si dhe trafikonin lëndë narkotike të llojit heroinë nga vendet e Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Në këto rrethana, nga Prokuroria për Krime të Rën-

da ka pranuar aktet dhe regjistroi procedimin penal 2016 për veprën penale parashtruar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal.

Gjatë hetimit nga organi procedues është urdhëruar regjistrimi i veprave penale të

parashikuara nga nenet 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Hetimet treguan se një grup personash, banorë në qytetet të ndryshme të vendit, vepronin në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, me qëllim kryerjen e ve-

prave penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimit të narkotikëve, si dhe dispononin pasuri të paluajtshme, të cilat dyshohet se janë produkt i veprave penale.

Gjatë hetimit po ashtu ka rezultuar se pjesëtar të këtij grupi kriminal kryenin edhe vepra penale të tjera, si korrupsioni në sektorë të publik të ndryshëm, si hipotekë, polici, bashki dhe në institucione të tjera të administratës shtetërore. Pasuritë e shtetasit Admir Hoxha dyshohet se janë vendosur nga të ardhurat e krijuara nga aktiviteti kriminal dhe bazuar në nenet 274, 275, 276, të Kodit Penal dhe neni 36 të Kodit të Procedurës Penale, nenin 11 të ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".

SHKURTE

Me minë me telekomandë dhe 7 kg drogë, arrestohet poseduesi

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka finalizuar operacionin "Zaranika", ku ka sekuestruar lëndë narkotike dhe minë me telekomandë si dhe ka arrestuar poseduesin e tyre. Në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e personave që tentojnë të trafikojnë lëndë narkotike apo lëndë plasëse, mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative, pas një hetimi me metoda speciale, blutë kanë arrestuar në flagrancë shtetasin A.R. Shërbimet e policisë gjatë kontrollit të ushtruar në qytetin e Elbasanit i kanë gjetur këtij shtetasi 1 minë me telekomandë, si dhe rreth 7 kg lëndë narkotike e llojit kanabis, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Në bashkëpunim me prokurorin vijon puna për zbardhjen e plotë të këtij rasti, identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të implikuar. Materialet në ngarkim të tij i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan për veprat penale të "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe municionit" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Vrasja në Ballsh, dy familjet kërkojnë kujdestarinë e fëmijëve

BALLSH - Pas më shumë se një muaji nga vrasja e dyfishtë që ndodhi në Ballsh, ku Gazmend Musta masakroi me thikë gruan dhe motrën e saj, familjarët e viktimit si dhe të autorit të vrasjes kërkojnë kujdestarinë për dy fëmijë të mitur. Në seancën e djeshme gjyqësore ishte i pranishëm edhe babai i fëmijëve (autor i vrasjes së nënës së tyre, Gentiana Çaushaj dhe motrës së kësaj të fundit Merisa Çaushaj). Daja i fëmijëve Gjyshmir Çaushaj, me një kërkesë drejtuar gjykatës së Fierit në datë 17 janar 2019, ka kërkuar kujdestarinë e mbesës dhe nipit të tij. Po të njëjtën gjë (disa ditë më vonë) kanë bërë edhe gjyshërit e dy fëmijëve, Bedri dhe Lumturi Musta, prindërit e Gazmend Musta. Seanca është shtyrë më 25 shkurt.

Ekzekutimi i ish-policit Arben Bilali, gjendet e braktisur makina e autorëve



Viktima Arben Bilali

va e vetme që ka në dorë policia për këtë ngjarje, pasi vrasësit janë treguar shumë të kujdesshëm duke mos lënë

gjurmë. Nga kamerat e sigurisë portretet e tyre nuk shquhen. Edhe ekzekutimin atentatorët e kryen pa zbr-

tur nga makina. Të gjitha këto kanë krijuar dyshimet tek hetuesit se kemi të bëjmë me vrasës me pagesë. Burime pranë grupit hetimor bënë me dije se dyshohet që atentatorët e kanë mbajtur nën vëzhgim prej kohësh 50-vjeçarin, i cili dilte shumë rrallë nga shtëpia, derisa gjetën momentin për ta eliminuar. Sipas hetuesve të çështjes, ish-policit kishte dalë nga banesa e tij trekatëshe disa orë para se ta qëllonin. Ai po kthehej në shtëpi me një automjet tip "Golf 4", ku po udhëtonte si pasagjer.

Banorët e qytetit të Kavajës: Jemi të shokuar, vajza është nxënëse e shkëlqyer

DURRËS

Përdhunimi i 13-vjeçares, minorenet: E merrnim pas mesimit në shtëpitë tona

Gjykata lë në burg 7 djemtë për marrëdhënie seksuale në grup, nëna e njërit prej të akuzuarve humb ndjenjat

Gjykata e Shkallës së Parë të Durrësit dje ka lënë në burg 7 minorenet, që akuzohen për marrëdhënie seksuale në grup me një 13-vjeçare nga Kavaja. Seanca gjyqësore ndaj 7 nxënësve të një shkolle 9-vjeçare në Kavajë u zhvillua me detyrë të mbyllura para-ditën e djeshme nga ora 10:30 deri në orën 13:00. Të pandehurit dolën para togave të zeza të qytetit bregdetar për rivlerësimin e masës së sigurisë, pasi akuzohen për "Marrëdhënie seksuale me të mitur". Pas marrjes në pyetje të të akuzuarve, gjykata ka lënë fuqi vendimin e mëparshëm të datës 1 shkurt për t'i mbajtur të miturit në burg, siç kërkoi edhe Prokuroria e Durrësit. Ndërkohë që njëri nga të pandehurit vijon të jetë në kërkim. Mësohet se para nisjes së seancës, familjarët e të akuzuarve, gjithashtu të mitur janë konfrontuar me gazetarët duke i ofenduar. Ata kërcënuan gazetarët që të mos bëjnë publike ngjarjen. Të miturit janë marrë në pyetje në prani të psikologes në polici, por edhe në gjykatë. Vajza e mitur e abuzuar ka pranuar abuzimin nga djemtë dhe ka rrëfyer për kërcënimet ndaj saj, gjithashtu në prani të psikologes dhe punonjësve sociale. Nga ana tjetër, jashtë gjykatës nënën e njërit prej djemve të vënë në akuzë për abuzim seksual në grup me 13-vjeçaren i ka rënë të fikët. "Gazeta Shqiptare" ka mundur të zbardhë pjesë të dëshmisë së minorenetëve, të cilat kanë qenë në kufijtë e të pabesueshmes. Në lidhje me historinë e tmerrshme të vajzës së mitur që ka tronditur tejet jo vetëm banorët e Kavajës, të por gjithë opinionin publik ka reaguar edhe Prokuroria e Durrësit, e cila ka bërë me dije se po hetohet intensivisht në lidhje me ngjarjen e rëndë, ndërsa ka sqaruar se ka vendosur të mos publikojë të dhënat e të akuzuarve për këtë rast.

DËSHIMITË E TË AKUZUARVE
Një histori e pabesueshme, në kufijtë e perversitetit, me protagonistë disa nxënës të një shkolle 9-vjeçare në Kavajë, që ka përrit sinjalet e alarmit për mijëra prindër e shkola të tjera në vend. I tillë është rasti i përdhunimit të një nxënëseje 13-vjeçare në Kavajë dy muaj më parë, por u bë publik vetëm para pak ditëve pas një denoncimi në "Facebook" nga ish-kryeministri Sali Berisha. Burime nga grupi hetimor bënë me dije për "GSI" se të gjithë djemtë e arrestuar e kanë pranuar që kanë kryer marrëdhënie seksuale me vajzën e mitur. Ata kanë thënë se gjithçka ndodhte pas përfundimit të mesimit. Mësohet se e mitura kishte simpati për një nga të akuzuarit. Fillimisht ajo është takuar në shtëpinë e një shoku të tij, ku kanë kryer marrëdhënie, ndërkohë që



Gjykata e Durrësit



Familjarët e të pandehurëve

TIRANË - Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri ka reaguar në lidhje me rastin e përdhunimit të 13-vjeçares në Kavajë nga djem që studionin bashkë me të në shkollën "Rilindja". CRCA Shqipëri i kërkoi Kuvendit të Shqipërisë, por edhe Prokurorisë të hetojnë thellë këtë çështje. Sipas tyre, grupi parlamentar "Miqë të Fëmijëve" t'i kërkojë Kuvendit krijimin e një komisioni të posaçëm hetimor për të hetuar të gjitha veprimet ose mosveprimet e institucioneve shtetërore si: Zyra Arsimore Kavajë, Komisarati i Policisë Kavajë, Bashkia Kavajë, për të parë nëse ato i kanë ushtruar ose jo detyrat e tyre institucionale, sipas kritereve të Ligjit 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve". Ndërsa Prokuroria e Përgjithshme duhet të hapë një hetim të plotë mbi ngjarjen për të parë të gjitha veprimet dhe mosveprimet e institucion-

"MASR të pezullojë zyrtarët arsimorë që kanë pasur dijeni" CRCA, apel Prokurorisë dhe Kuvendit, hetim të plotë e të thellë për ngjarjen në Kavajë



Shkolla 9-vjeçare në Kavajë

eve përkatëse, si dhe duke vlerësuar faktet, ajo duhet të marrë në konsideratë nëse janë kryer ose jo vepra të tjera penale si pornografia me fëmijë etj. Po ashtu, edhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të pezullojë menjëherë të gjithë zyrtarët arsimorë, të të gjitha niveleve, që kanë pasur dijeni dhe që nuk kanë reaguar lidhur me ngjarjen në fjalë dhe denoncimin e tyre

prindërit e tyre ishin në punë. Policia dhe prokuroria ka marrë në pyetje mesuesen kujdestare, drejtoreshën e shkollës, por kanë deklaruar se nuk dinin gjë.

BANORËT

Të shokuar nga ngjarja, prindërit e nxënësve të tjerë të shkollës 9-vjeçare "Rilindja" në Kavajë kanë vendosur të mos i lënë fëmijët asnjë minutë vetëm. Ata thanë ditën e djeshme se e kanë mësuar rastin vetëm kur u

afatshkurtë dhe afatgjatë, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burjeve duhet të ofrojë shërbim të specializuar dhe mbështetje psiko-sociale edhe për adoleshentët e dyshuar si autorë të kësaj veprë penale. Të gjithë personat e përfshirë në këtë ngjarje të rëndë janë adoleshentë, ndaj pavarësisht rolit, ata kanë nevojë për të marrë trajtimin dhe kujdesin e duhur. Prokuroria e Përgjithshme duhet të hapë një hetim të plotë mbi ngjarjen për të parë të gjitha veprimet dhe mosveprimet e institucioneve përkatëse, si dhe duke vlerësuar faktet, ajo duhet të marrë në konsideratë nëse janë kryer ose jo vepra të tjera penale si pornografia me fëmijë, etj.

bë publik në media, ndërsa flasin fjalët më të mira për familjen e vajzës minorene. "Jemi të shokuar nga ngjarja. Fëmijët nuk na kanë treguar çfarë ka ndodhur. Rastin e mësuam kur u bë publik. Nuk duhet të hidhet balta mbi shkollën. Nuk ka faj shkolla. Ngjarja ka ndodhur jashtë", janë shprehur ata. Ndërkohë fëmijët kanë treguar se prindërit se vajza e abuzuar nuk ka shfaqur asnjë shenjë të çuditshme. Me gjithë rastin e

Babai: Vajzën e shantazhuan përmes një videoje intime

KAVAJË - Pas ngjarjes së rëndë në qytetin e Kavajës, ka reaguar për "Top Chanel" edhe babai i 13-vjeçares. Ai është shprehur se gjithçka ka nisur, pasi vajza e tij hyri në marrëdhënie me një shokun e klasës. Ky i fundit, në pabesi e kishte shikuar me anë të një shoku tjetër duke kryer marrëdhënie dhe përmes kësaj videoje, ata e shantazhuan vajzën. Nëse ajo nuk i nënshtrohej marrëdhënies seksuale në grup me shokë të tjerë, ata do t'i publikonin videon për ta turpëruar në sytë e të gjithëve". Sipas gazetares Juli Ristani të "Top Chanel", vajza ndodhet aktualisht në gjendje të qëndrueshme psikike, ndërsa i është nënshtruar edhe ekspertizës mjekëgjore, pas së cilës mjekët kanë dalë të tronditur. Por babai ka thënë se tashmë po përgatitet ta largojë vajzën nga Kavaja, për t'i siguruar asaj një jetë më të mirë në një vend të Bashkimit Europian.

Prokuroria: Abuzuesit janë të mitur, s'i publikojmë emrat

Prokuroria e Durrësit dje deklaroi se abuzimi i vajzës 13-vjeçare në qytetin e Kavajës po trajtohet me impemjimin e duhur dhe maksimal. Në një deklaratë për mediat, organi i akuzës sqaroi se rasti po hetohet nga prokurorë të seksionit për të mitur. "Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës po kryhen hetimet për çështjen penale, që bën fjalë për veprën penale të marrëdhënies seksuale me të mitur, parashikuar nga neni 100/2K.Penal. Rasti në fjalë po trajtohet me impemjimin e duhur dhe maksimal në zbatim të detyrës dhe në përputhje me normat dhe detyrimet që parashikohen Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", thuhet ndër të tjera në deklaratën në fjalë. Organi i akuzës sqaroi se nuk mund të japë informacion mbi identitetin e personave të përfshirë në këtë ngjarje, për shkak se ata janë të gjithë të mitur.

Gruaja që hetoi dhe burgosi ish-kryeministrin Ivo Sanader do të qëndrojë 2 vite në Shqipëri

SPAK, "super-prokurorja" kroate në Tiranë

Luigi Soreca i BE: Karburanti shkoi në motor, gati Byroja e Hetimit

Për 2 vite rresht, ajo do të japë eksperiencën e saj se si hetohet korrupsioni dhe si hetohen zyrtarët më të lartë. Gjatë një takimi me dyer të mbyllura, Laptosh tregoi se për të hetuar korrupsionin duhet së pari, që të përzgjedhurit e SPAK-ut të kenë besueshmëri të lartë, të ketë koordinim mes Gjykatës kundër Korrupsionit dhe SPAK-ut si edhe të ketë vullnet.

"Kur unë po hetoja ish-kryeministrin, besueshmëria e publikut nuk ishte shumë e lartë, sepse ai ishte i fuqishëm dhe arrogant. Ne vinim nga një eksperiencë në të cilën nuk ishte hetuar ekzekutivi, por më pas u mblodhën prova dhe gjatë procesit besueshmëria e publikut u rrit", ka thënë Laptosh raporton "Top Channel".

Por, njëra nga prokurorët pyeti se a ishte e mundur që një grup prokurorësh të mund të thyejë korrupsionin dhe të kthejë besimin e publikut, pyetje për të cilën mori përgjigje pozitive, sepse sipas prokurores speciale të USKOK, prokurorët e SPAK-ut duhet të kenë parasysh që të hetojnë jo vetëm korrupsionin, por edhe të konfiskohen asetet e këtij krimi.

Deri më tani kanë aplikuar vetëm 12 prokurorë për në SPAK, ndërsa prokuroria e posaçme duhet të ketë 15 prokurorë. Megjithatë takimi ishte për të inspiruar prokurorët për të garuar,



Tamar Laptosh, prokurorja speciale e USKOK



QENDRIMI I BE

Soreca tha se çështja e reformës në drejtësi është e ndërlikuar dhe komplekse. Gjatë një deklarate për gazetaret, Soreca garanoi se shumë shpejt do të krijohet SPAK, BKH dhe Gjykata Kushtetuese.

het SPAK, BKH dhe Gjykata Kushtetuese.

"Reforma në drejtësi është një çështje e ndërlikuar dhe komplekse. Është një çështje që është ndjekur gjatë gjithë kohës. Vetëm këtë javë jemi takuar 3 herë për këtë çështje. Është si puna e karburantit, që është dashur pak kohë që karburanti të shkojë tek motori, tani që motori do të ndizet do të kemi të gjitha SPAK, BKH dhe natyrisht edhe Gjykatën Kushtetuese. Në po ndjekim strategjinë 2019-2023. Në fakt, karburanti na qenë naftë, sepse karburanti naftë është më i mirë dhe zgjat më shumë", deklaroi ai.

AMBASADORI

"Reforma në drejtësi është një çështje e ndërlikuar dhe komplekse. Është një çështje që është ndjekur gjatë gjithë kohës. Vetëm këtë javë jemi takuar 3 herë për këtë çështje".

nuk munguan edhe prokurorët që ndërkohë kanë dhënë pëlqimin që të jenë dora e fortë kundër zyrtarëve dhe politikanëve të

korruptuar. **BASHKIMI EUROPIAN** Ambasadori Luigi Soreca e përsëriti edhe në mbyllje të aktivitetit apelin e tij: "Deri

tani kemi pasur mjaft aplikime, por do të ishte më mirë të kishte aplikime të tjera, pasi mendojmë që sa më shumë aplikime të kemi, aq më shumë do të ketë mundësi përzgjedhjeje për më të mirët. Prandaj ne dëshironim që të bisedonim me të gjithë ata që janë të interesuar për t'u bërë pjesë e SPAK-ut, në mënyrë që t'u bëjmë thirrje edhe njëherë atyre. Ju më keni dëgjuar të them se reforma në drejtësi është mjaft e rëndësishme për Shqipërinë dhe sigur-

isht kjo është e vërtetë, por është akoma më e rëndësishme që qytetarët e thjeshtë të marrin drejtësi". Në datën 7 shkurt mbyllet afati për të dorëzuar dokumentacionin për në SPAK, prokurorisë që do të hapë perden për të kuptuar me prova se deri ku korrupsioni ka implikuar zyrtarët. Soreca tha se çështja e reformës në drejtësi është e ndërlikuar dhe komplekse. Gjatë një deklarate për gazetaret, Soreca garanoi se shumë shpejt do të krijo-



Tabaku: Dhuna e taksave nuk duhet të shtypë lirinë e askujt

Deputetja e PD, Jorida Tabaku, ka denoncuar përmes fotove në "Facebook", mbylljen e bizneseve në Tiranë. Në postimin e saj, Tabaku shkruan se prej vitit 2009 takon së paku një herë në muaj bizneset e njësisë 8, por kurrë nuk ka hasur në fytyrat e tyre pesimizim që vëren kohët e fundit. "Kurrë më parë nuk kisha parë mbi 20 biznese të mbyllura, që kishin ulur qepenat që të hënë në një nga pjesët më të populluara në qytet. Në ato pak biznese që gjeta hapur dhe që bisedova me pronarët apo shitësit, dëgjova të njëjtin refren "Taksat e larta, çmimi i lartë i ujit, çmimi i lartë i dritave". Dikush kish vendosur të hiqte nga fitimi i tij, pra buka e gojës së tij, për të paguar taksat e qeverisë pa rritur çmimin e produkteve. Nuk kishte si të vepronte ndryshe, pasi edhe me këtë lëvizje sërishmi konsumi ishte në kuotat minimale", - shkruan Tabaku, ndërsa ndan shqetësimin e bizneseve për rritjen e taksave.

Protesta, banorët e 'Unazës së Re', Ramës: Me hir apo me pahir do të të rrëzojmë



Banorët të zonës së 'Unazës së Re' në kryeqytet kanë dalë pasditen e djeshme në protestë. Banorët, që sot vijnë ditën e 93 të qëndrës, kundërshtojnë projektin për rikonstruktimin e rrugës nga sheshi "Shqiponja" te mbikalimi pranë "Pallatit me Shigjeta", që parashikon shembjen e banesave të tyre. "Me hir hip a me pahir ne këtë (Ramën) do ta rrëzojmë", u tha nga megafoni i protestës. Deputetë të opozitës ishin në mbështetje të protestës. Llixhat me koncesion, Xhaçka jep lajmin e mirë për Peshkopinë Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ka zhvilluar një takim me banorët, punonjësit dhe bizneset e Qendrës Balneare në Peshkopinë (Burimi Termomineral i Llixhave). Ministria Xhaçka u tha banorëve vendimin e anulimit të dhënies

në përdorim për 5 vjet të ujërave termale. "Vendimi i Këshillit të Basenit të Ujërave Buna-Drini anulohet. Vendimi na ka shqetësuar të gjithëve. Vendimi, i marrë në mungesë të plotë transparence dhe abuziv.

Përfaqësuesit e qeverisë në atë këshill janë përballur me faktin e kryer dhe kanë debatuar kundër vendimit. Nga hetimi administrativ që ka bërë zyra e kryeministrit, vendimi do të anulohet. Përgjegjësit e këtij vendimi

TAKIMI

Llixhat me koncesion, Xhaçka jep lajmin e mirë për Peshkopinë Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ka zhvilluar një takim me banorët, punonjësit dhe bizneset e Qendrës Balneare në Peshkopinë (Burimi Termomineral i Llixhave). Ministria Xhaçka u tha banorëve vendimin e anulimit të dhënies në përdorim për 5 vjet të ujërave termale.

do të marrin përgjegjësitë", u shpreh Xhaçka. Ajo kërkoi administrim më të mirë të Burimit Termomineral të Llixhave. Ministria bisedoi me bizneset edhe për zhvillimin e mëtejshëm të llixhave.

Kërkohet unifikim i praktikave administrative

Analiza për inspektimet, si do kryhet reforma

Këshilli i Investimeve (KI) ka kryer një analizë "Mbi Inspektimet", një punim që përbën një hap të parë drejt një analize më të thelluar në 2019-ën dhe synon të tërheqë vëmendjen mbi rëndësinë e reformës, në kuadër edhe të proceseve të integritetit të vendit në BE. Drejtorja e Sekretariatit të KI, znj. Diana Leka, në mbledhjen e fundit të këshillit prezantoi analizën "Mbi Inspektimet". Gjetjet e analizës u fokusuan në tri shtylla: strategjike, ligjore dhe kapacitete institucionale. Mesazhet e analizës dhe konsultimeve të Sekretariatit në lidhje me temën e diskutimit mund të përmbledhen si më poshtë: a) Reformë në mënyrë të integritetit të inspektimit, si pjesë e re-

formës derregulatore, kërkon një moment reflektimi dhe vlerësimi të impaktit dhe arrijtjeve të deritanishme dhe prioritetin e ndërhyrjeve të mëtejshme, të integruara me reformat e tjera strukturore në administratën publike. b) Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, si parakusht për suksesin e reformës së inspektimeve duhet të konsolidohet në vijimësi. c) Progresi i inspektimeve 'online' duhet të shoqërohet edhe me unifikimin e praktikave administrative nëpërmjet publikimit të komentarëve si edhe rritjes së

kapaciteteve njëzëre të qëndrueshme, të trajnuara dhe të azhurnuara me legjislacionin, në inspektoratet shtetërore. Përfaqësuesit nga biznesi vlerësuan tematikën si mjaft aktuale dhe materialin e përgatitur për mesazhet e qarta në lidhje me rëndësinë e formalizimit, konkurrencës së ndershme, inspektimeve si dhe koordinimit ndërinstitucional si hallka të barasvlefshme të zinxhirit që influencojnë qartë klimën e investimeve. U pranua se qasja e inspektorëve ndaj sipërmarrjes ka ndryshuar në raport me disa vite më parë, por u

nënvizua se hapësirat për përmirësimin e procedurave të inspektimit, transparencës dhe efikasitetit të tyre janë ende të mëdha. Gjithashtu, ata rekomanduan një vëmendje më të madhe tek inspektimet në nivel vendor, pasi shpesh ka pasur mbivendosje me inspektimet qendrore duke krijuar kosto të bizneset dhe theksuan rëndësinë e konsultimit praktik të vendosjes së normativave në fusha specifike të inspektimeve (i cili do të trishtë standardet e përputhshmërisë së bizneseve) dhe një kuadër nënligjor të qën-



drueshëm. Ndërkohë, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Eduard Shalsi, theksoi se inspektimet janë një fushë, e cila prej kohësh ka qenë një shqetësim për të gjithë. Ai u shpreh se materiali i përgatitur nga sekretariatit është interesant për tu analizuar dhe kuptuar, nga ku mund të nxirren disa konkluzione me afate konkrete në lidhje me punën e inspektorateve. Z. Shalsi u shpreh se ndonëse ka pasur progres të dukshëm në punën e deritanishme, ende ka shumë për të bërë, veçanërisht në lidhje me komunikimin ndërinstitucional.

Debati për kontratat e HEC-eve në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese

Ahmeti: Ndryshime ligjore, para pajisjes me licencë duhet "leje" nga ujërat

Baraj: Të mos ndërtohen vepra kur dëmtojnë mjedisin

Enti Rregullator i Energjisë po miraton disa ndryshime ligjore për licencat e hidrocentraleve, duke synuar mbrojtjen e mjedisit. Sipas kreut të këtij institucioni, Petrit Ahmeti, përpara se të pajisen me licencë, këto subjekte duhet të marrin një opinion nga institucionet përgjegjëse për ndërtimin e rezervave ujore. Ndërkaq, deputeti Besnik Baraj ka kërkuar gjetjen e mekanizmeve për moslejimin e ndërtimit të këtyre veprave energjetike, në rast se ato dëmtojnë mjedisin, por sipas Ahmetit, duhen diskutime të mëtejshme në këtë drejtim. Ndryshimet ligjore nga ana e Entit Rregullator të Energjisë vijnë pas nisjes së skanimit të kontratave koncesionare nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ku një prej kriterëve të këtij procesi do të bazohet në faktin nëse këto kontrata koncesionare janë në përputhje me kushtet mjedisore dhe standardet e kërkuara në zonat përkatëse.

kreuesin drejtuar Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin si dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut kanë paraqitur shqetësimin dhe nevojën emergjente për

ndërhyrje në paketën ligjore të koncesioneve, kryesisht lidhur me lejet e HEC-eve. Planet e zhvillimit të veprave hidro-energetike tregojnë se 540 hidrocentrale janë planifikuar për t'u ndërtuar në gjithë territorin e Shqipërisë, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve në zona të mbrojtura

(rreth 61) dhe zona me potencial të lartë natyror. "EcoAlbania" dhe ekipi i ekspertëve thonë se synojnë diskutimin e tyre në Komisionet Parlamentare përkatëse dhe nxitjen e ndryshimeve ligjore në drejtim të përmirësimit të legjislacionit për koncesionet e HEC-eve në Shqipëri. "EcoAlbania" thotë se është angazhuar në nxitjen e nismës së shoqërisë civile për përmirësimin e legjislacionit për koncesionet e HEC-eve në Shqipëri.



Kreu i IERE institucioni, Petrit Ahmeti

KËRKESA
Ndërkohë, "EcoAlbania" ka dërguar një kërkesë zyrtare në Kuvendin e Shqipërisë për disa ndryshime në Ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat". Disa organizata mjedisore, ekspertë, përfaqësues të pushtetit vendor dhe banorëve të prekur nga zhvillimi i projekteve hidro-energetike, në sh-

KRITERET

Ndryshimet ligjore nga ana e Entit Rregullator të Energjisë vijnë pas nisjes së skanimit të kontratave koncesionare nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ku një prej kriterëve të këtij procesi do të bazohet në faktin nëse këto kontrata koncesionare janë në përputhje me kushtet mjedisore dhe standardet e kërkuara në zonat përkatëse.

Deficiti buxhetor u financua i gjithi nga jashtë

I gjithë deficiti buxhetor vitin e kaluar u financua me huamarrje të jashtme. Sipas të dhënave nga Ministria e Financave, për vitin 2018 buxheti regjistroi një deficit prej 26.5 miliardë lekësh, rreth 18% më të ulët se plani. I gjithë ky deficit u financua nga huamarrja e jashtme dhe kryesisht nga eurobondi i emetuar gjatë tetorit. Madje, eurobondi shërbeu edhe një zëvendësim të huamarrjes ekzistuese të brendshme. Përkundrajt një huamarrjeje të brendshme prej pak më shumë se 19 miliardë lekësh, qeveria shqiptare bëri ripagesa në vlerën e 26 miliardë lekëve. Bilanci i huamarrjes së brendshme vitin e kaluar të ishte negativ, çka do të thotë se qeveria shleu më shumë borxh nga sa mori. Përmes huamarrjes së jashtme, qeveria ka çliruar likuiditetet të shumta të lira në tregun e brendshëm financiar, çka shpjegon në një pjesë të madhe uljen drastike të interesave të bonove dhe obligacioneve gjatë muajve të fundit të vitit 2018. Kjo tendencë vazhdoi edhe gjatë muajit janar. Interesat për të gjitha instrumentet e borxhit qeveritar kanë zbritur pranë niveleve më të ulëta historike. Likuiditeti i lartë dhe interesat e ulëta në tregun e bonove, në teori, është një shtysë që bankat të gllorjnë ofertën për kredi në lekë dhe të ulin më tej normat e interesit. Një tendencë pozitive vërehet prej vitesh në kreditimin e individëve, si për blerjen e pasurive të paluajtshme, ashtu edhe për konsum. Sado që cikli i politikës monetare stimuluese është drejt mbylljes, lëvizja e qeverisë duket se do të ndikojë në ruajtjen e normave minimale të interesit në tregun financiar shqiptar. Përfituese në radhë të parë është vetë qeveria, që po siguron interesa më të ulëta për borxhin e vet, por gjasat janë që kjo konjunkturë të favorizojë edhe individët dhe bizneset huamarrëse.

United Nations Development Programme



VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.
Post Title: Archiving Specialist (2 posts)
Duty station: Tirana
Duration of Assignment: 10 days/month during the period February - December 2019
Type of Contract: Individual Contract

Educational Background: Bachelor's Degree in archiving, history and philology, public/business administration, informatics or other related fields

Work Experience: At least 3 years of working experience in public administration or in a project environment. Experience with document management processes at public and private sector, protocol and archiving processes. Work experience exposed to relations with local government matters. Knowledge of local government development in Albania and local government operations

Demonstrated understanding of Albania's local governance system. Experience in integrated governance programming / institutional development.

Tentative Starting Date: 01 March 2019
Deadline for Application: 15-Feb-19

Job Description: Available at UNDP site: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>
 Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.



Kuçi

"NUK KEMI FRIKË"

"Ne nuk trembemi as nga shtyrja e as nga humbja e vitit akademik. Qeveria duhet të trembet nga ne, që ia kemi treguar që nuk e hamë sapunin për djathtë as me VKM-të që miraton e as me Paktet për Universitetin. Ne nuk do të ndalemi deri sa ligji i arsimit të lartë të bjerë", - shprehet Kuçi për "GSH".



Zoto

"PEDAGOGËT, MBËSHETJE"

"Vazhdon bojkoti masiv të Shkencat Sociale, Filologjiku dhe i gjithë Universiteti i Shkodrës. Kurse Juridiku vazhdon një pjesë e vogël të bëjë mësim te gjimnazi "Petro Nini Luarasi". Grevën e pedagogëve e shohim si një mbështetje për të çuar më përpara plotësimin e kërkesave tona", - thekson studenti Kristijan Zoto për "GSH".



Çibuku

"BOJKOTI DO TË VAZHDOJË"

"Fakulteti i Shkencave Sociale tani ka edhe mbështetjen e pedagogëve dhe do të vazhdojnë bojkotin e mësimit deri në plotësimin e kërkesave që i kemi parashtruar qeverisë dhe ministrisë. Ndërsa Filologjiku po pret për vendimin e Asamblesë së pedagogëve", - thotë për "Gazeta Shqiptare" studentja Arbjoja Çibuku.

Voltiza Duro

Arlind Qori, thirrje për bashkim: Pse kërkojmë rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë

Pedagogët e Shkencave Sociale hyjnë në grevë pa afat

Studentët: Ne nuk ndalemi, qeveria të na e ketë frikën



Arrin në 3 numri i të vdekurve nga gripi

Ka arritur në 3 numri i personave që kanë ndërruar jetë nga gripi në spitalin universitar Shefqet Ndroqi në Tiranë. Ndërkohë specialistja Silva Bino, shefe e departamentit të sëmundjeve infektive ne ISHP në një deklaratë për mediat theksoi se 2 raste janë konfirmuar që kanë vdekur nga gripi e pritë që të bëhen verifikimet e nevojshme edhe për rastin e tretë nga Gramshi. "2 raste të konfirmuara me gripi dhe një rast tjetër që mendohet për gripi, dhe po verifikohet nëse ka qenë si pasojë e gripit, ka ndërruar jetë në Sanatorium" - ka thënë mjekja.



Pedagogu, Arlind Qori



Situata dje në Fakultetin e Shkencave Sociale

Në një kohë që studentët e Shkencave Sociale, Filologjikut e një pjesë e Juridikut vazhdojnë bojkotin e mësimit, pedagogët kanë vendosur dje që të nisnin grevën deri në rrëzimin e ligjit për arsimin e lartë. Ditën e djeshme, përmes një vendimi me shumicë votash, drejtuesit e personelit akademik të Fakultetit të Shkencave Sociale kanë vendosur të përshkallëzojnë protestën. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", pedagogu Arlind Qori tregon arsyet kryesore që shtynë stafin akademik të marrin këtë vendim. Ai thekson se midis pedagogëve ka mendime dhe qëndrime në ndryshme, por jo përplasje dhe do t'i qëndrojnë vendimit të tyre deri në plotësimin e kërkesave. Pedagogu shton se ligji i arsimit të lartë varfëron dhe komercializon universitetet publike, i kthen studentët në klientë dhe pedagogët në punëtorë me mëdijtë, madje zhbën demokracinë e brendshme dhe autonominë universitare.

Pedagogët e Fakultetit të Shkencave Sociale në UT vendosën të hyjnë në grevë. Pse erdhni ky vendim dhe sa do të zgjasë greva?

Ka disa arsye. E para, ka të bëjë me dhënie dhe një shenjë solidariteti me kërkesat dhe rezistencën dymujore të studentëve tanë. E dyta, lidhet me kundërshtinë tonë të thellë ndaj ligjit të arsimit të lartë dhe tentativave të qeverisë për të vrarë edhe atë pak autonomi universitare që na ka mbetur. E treta, dhe besoj se në këto kushte është edhe më e rëndësishmja, është dinjteti. Këtu nuk e kam fjalën për fyerjet prej pijaneci vulëhumbur të kreut të qeverisë, por për mënyrën se si ministria e Arsimit i ka përçelë përfaqësuesit tanë pa denjuar as t'u japë një përgjigje negative në takimin e të premtës.

A ka pasur përplasje mes pedagogëve lidhur me kauzën universitare?

Midis pedagogëve ka mendime dhe qëndrime në ndryshme, por jo përplasje. Në fakt, kjo larmi është shenjë e demokracisë së shëndosë brenda universitetit. Gjithsesi, në shumicë absolute, pedagogët e FSHS janë shprehur në asamble për grevë dhe do t'i qëndrojnë vendimit të tyre. Ata pak kolegë që janë

ALBIN KURTI, PRO STUDENTËVE

"Fitoret në histori në shoqëri vijnë nga qëndresa. Aktivizimin e kam filluar pikërisht në krye të protestave studentore në Kosovë. Protesta e studentëve, e drejtë kur pedagogët janë me ta. Ndërhyrja e studentëve nuk është për të qeshur. Me protestat vjen pranvera. Kjo protestë është kundër privilegjëve që kanë të pasurit", është shprehur Kurti.



STUDENTËT E SHKODRËS, BOJKOT

Studentët e universitetit të Shkodrës kanë vendosur të kundërshtojnë vendimin e rektoratit për t'u rikthyer në mësim. Ata kanë vazhduar bojkotin e në shenjë proteste vendosën të bllokojnë me karrige derën hyrëse të zyrave të administratës, duke mos lejuar që të zhvillohet procesi mësimor.



kundër grevës apo kërkesave tona e thonë hapur se i shtyn frika. Kësaj, një arsye më shumë për të vazhduar rezistencën tonë është shpëtimi i universitetit nga kthetrat e frikës që, kur u kallet pedagogëve, merre me mend se sa e thellë dhe degraduese është.

A u janë bashkuar grevës edhe pedagogë nga fakultetet të tjera?
U kemi bërë thirrje asamble të fakulteteve të tjera

që të na bashkohen. Sot (dje) pati një takim të pedagogëve nga shumë fakultete dhe universitetet publike dhe mbajmë shpresë se ata do ta thonë fjalën e tyre brenda fakulteteve përkatëse.

Nëse nuk do të plotësohen kërkesat, a do të përshkallëzohet kjo formë e protestës?

I vetmi përshkallëzim i mundshëm është masiviteti. Nëse bashkohen pedagogë dhe shumësia studentore,

atëherë qeveria nuk do të ketë rrugëdalje tjetër përpos kapitullimit pa kushte.

Cili është reagimi juaj ndaj deklaratave të ministres Besa Shahini, e cila thekson se është për përmirësimin e arsimit të lartë, por kundër ndryshimit të VKM-ve?

Për mendimin tim, VKM janë të një rëndësie dytësore. Thelbi i krahurës është ligji i arsimit të lartë. Ky ligj i varfëron dhe komercializon

universitetet publike, i kthen studentët në klientë dhe pedagogët në punëtorë me mëdijtë dhe zhbën demokracinë e brendshme dhe autonominë universitare. Se si mund të përmirësohet jeta universitare pa rrëzimin e këtij ligji vetëm gjenitë e pakuptuar të qeverisë mund ta mendojnë.

A ndihën të frikësuar studentët se mund t'u digjet viti akademik?

Qeveria po përpiqet në mënyrë sistematike për të mbjellë panik midis studentëve. Madje, i fton ata të konfliktohen me njëri-tjetrin në shkollë e fakulteteve apo kërkon t'i ndërsejë kundër pedagogëve në grevë. Mirëpo edhe për studentët, vlen ajo që vura në dukje për pedagogët: ne duhet të luftojmë për një universitet të ri, të shprehës, kundër frikës. Nga ana tjetër, me aq përvojë sa kam në universitet, mund të them me siguri se viti akademik nuk do të digjet edhe sikur kjo grevë dhe protesta studentore të zgjasë. Janë të gjitha mundësitë teknike të rregullimit të orareve, sezoneve të provimeve etj. Po sot duhet të bëjmë ç'është e mundur që të fitojmë universitetin e aspiratave tona më të larta.

tha ajo.

PENSIONET E PLEQËRISË MASA E LLOGARITUR

Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Hapat që duhet të ndiqni për rishqyrtim

Voltiza Duro

Me mbushjen e moshës së daljes në pension, Instituti i Sigurimeve Shoqërore përcakton masën e pensionit që u takon qytetarëve, bazuar në vitet e punës me kontribute. Por jo pak individë, shpeshherë shfaqin pakënaqësi lidhur me pagesën që do të marrin e madje, nuk dinë ku të drejtohen, ose si të veprojnë për të marrë një masë më të lartë pensioni se ai që ka përllogaritur institucioni përkatës. Lidhur me të gjitha këto paqartësi nga ana e të moshuarve, "Gazeta Shqiptare" publikon sot procedurën e plotë që duhet të ndjekin individët, në mënyrë që të marrin më shumë para se masa e caktuar. Paraprakisht, të interesuarit duhet të bëjnë një kërkesë në portalin qeveritar "e-Albania" si dhe duhet të dorëzojnë dokumentacionin e plotë.

HAPAT PËR RIAPLIKIM

Pas marrjes së vendimit të caktimit të pensionit, përfuties ka të drejtë të aplikojë për rishqyrtim pensioni për të dorëzuar dokumentacion shtesë, për një masë më të lartë përfitimi ose për zgjatjen e afatit të përfitimit për pensionet invalid, familjar dhe suplementar të parakohshëm. "Ky shërbim ju ofron mundësinë për të plotësuar një kërkesë 'online' për rishqyrtimin e përfitimit tuaj (sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar)", - theksohet në portalin qeveritar "e-Albania". Për të pasur akses në këtë të fundit, të interesuarit duhet të regjistrohen si qytetar në portal dhe të plotësojnë formën përkatëse për këtë kërkesë, e cila do të hapet menjëherë pas klikimit të butonit "Përdor" në krah të këtij shërbimi. Më tej në portal bëhet me dije se numri i sigurimit plotësohet paraprakisht në momentin që aplikanti hyn në portal me kredencialet e tij përkatëse. "Me informacionin e numrit tuaj të sigurimit plotësohen automatikisht edhe të dhënat e tjera nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ju duhet të plotësoni formularin sipas fushave. Numri dhe data e protokollit do plotësohet nga punonjësit tanë. Ju mund ta ruani formën si draft për të vazhduar në një moment tjetër ose mund ta dërgoni menjëherë në serverin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore", - nënvizon "e-Albania" për të gjithë pensionistët që dëshirojnë të

Zbardhet procedura për rritjen e masës së pensionit të pleqërisë

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë të moshuarit



HAPAT E PROCEDURËS

- Për të përdorur shërbimin duhet të regjistroheni si qytetar në portal dhe të plotësoni formën përkatëse për këtë kërkesë, e cila hapet menjëherë kur klikoni butonin "Përdor" në krah të këtij shërbimi.
- Numri juaj i sigurimit plotësohet paraprakisht në momentin që ju hyni në portal me kredencialet tuaja.
- Me informacionin e numrit tuaj të sigurimit plotësohen automatikisht edhe të dhënat e tjera nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
- Ju duhet të plotësoni formularin sipas fushave.
- Numri dhe data e protokollit do plotësohet nga punonjësit tanë.
- Ju mund ta ruani formën si draft për të vazhduar në një moment tjetër ose mund ta dërgoni menjëherë për procesim në serverin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

aplikojnë për rishqyrtim të masës së pensionit. Ndërkohë të gjithë aplikantët pasi të kenë përdorur këtë shërbim elektronik, duhet të paraqiten në zyrat e agjencive lokale për të dorëzuar dokumentacionin e kërkuar.

DOKUMENTET QË NEVOJITEN

Dokumentet e nevojshme për rishqyrtim janë në varësi të objektivit të rishqyrtimit. Por, aplikantët duhet të kenë parasysh që të dorëzojnë një kopje të kartës së identitetit, ose certifikatë personale, një certifikatë familjare, vërtetim për pagat pas vitit 1993, vërtetim nga

arshiva e ISSH-së, DRSSH-së për vjetërsi në punë; vërtetim për kontributet si i vetëpunësuar në bujqësi, vërtetim për kohën e kryerjes së shërbimit ushtarak, vërtetim nga shkolla, kur fëmija është 18 vjeç - 25 vjeç, vërtetim nga Tatim Taksat për pjesëtarët që ka në ngarkim, si dhe një vërtetim nga Zyra e Punës si punëkërkuar. Ndërkohë të interesuarit duhet të dorëzojnë edhe një fotokopje të kontratës me KESH-in; dëshminë e penaltetit për të përndjekurit politikë, vërtetim i kohës së vuajtjes së dënimit (të përndjekurit politikë), diplomën e shkollës së lartë, fletëdrejtimi për në KMCAP dhe fletëdaljet nga spitali, analiza mjekësore sipas diagnozës, vërtetim identitetit, aktverifikim, vendim gjykate, deklaratë individuale për punësim (e përvitshme) mod. 09 si dhe një deklaratë individuale që nuk është i punësuar (mod. 08). Gjithashtu, pensionistët duhet të paraqesin pranë zyrave përkatëse edhe vërtetimin e pagës referuese modelar nr.02, vërtetim i pagës mesatare referuese modelar nr.03, vërtetim i viteve të shërbimit mod.09, vërtetim për periudhën e shërbimit në funksion apo detyrë,

KËRKESA

Pas marrjes së vendimit të caktimit të pensionit, përfuties ka të drejtë të aplikojë për rishqyrtim pensioni për të dorëzuar dokumentacion shtesë, për një masë më të lartë përfitimi, ose për zgjatjen e afatit të përfitimit për pensionet invalid, familjar dhe suplementar të parakohshëm.

DOKUMENTET QË MUND TË DORËZOHEN JANË:

- Kopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale.
- Certifikatë familjare.
- Vërtetim për pagat pas vitit 1993.
- Vërtetim nga arshiva e ISSH-së, DRSSH-së për vjetërsi në punë.
- Vërtetim për kontributet si i vetëpunësuar në bujqësi.
- Vërtetim për kohën e kryerjes së shërbimit ushtarak.
- Vërtetim nga shkolla, kur fëmija është 18 vjeç - 25 vjeç.
- Vërtetim nga Tatim Taksat për pjesëtarët që ka në ngarkim.
- Vërtetim nga Zyra e Punës si punëkërkuar.
- Fotokopje të kontratës me KESH-in.
- Dëshmi penaltetit për të përndjekurit politikë.
- Vërtetim i kohës së vuajtjes së dënimit (të përndjekurit politikë).
- Diplomën e shkollës së lartë.
- Fletëdrejtimi për në KMCAP dhe fletëdaljet nga spitali.
- Analiza mjekësore sipas diagnozës.
- Vërtetim identitetit.
- Aktverifikim.
- Vendim gjykate.
- Deklaratë individuale për punësim (e përvitshme) mod. 09.
- Deklaratë individuale që nuk jam i punësuar (mod. 08).
- Vërtetim i pagës referuese modelar nr.02.
- Vërtetim i pagës mesatare referuese modelar nr.03.
- Vërtetim i viteve të shërbimit mod.09.
- Vërtetim për derdhje të kontributit suplementar nr.08.
- Vërtetim page referuese të përfitimit shtetëror suplementar.
- Vërtetim për periudhën e shërbimit në funksion apo detyrë.
- Vërtetim për derdhje të kontributit suplementar.
- Vërtetim i pagës referuese.
- Vërtetim për periudhën e shërbimit.

mentar nr.08, vërtetim page referuese të përfitimit shtetëror suplementar, vërtetim për periudhën e shërbimit në funksion apo detyrë,

vërtetim për derdhje të kontributit suplementar, vërtetim i pagës referuese si dhe një vërtetim për periudhën e shërbimit.

Table with 15 columns: Nr, Emër, Mbledhësi, Qarku, Profesioni, Pikët. Includes entries for Qarku Berat Fizioterapist.

Table with 15 columns: Nr, Emër, Mbledhësi, Qarku, Profesioni, Pikët. Includes entries for Qarku Berat infermier.

Table with 15 columns: Nr, Emër, Mbledhësi, Qarku, Profesioni, Pikët. Includes entries for Qarku Elbasan Mami.

Table with 15 columns: Nr, Emër, Mbledhësi, Qarku, Profesioni, Pikët. Includes entries for Qarku Elbasan Mbledhësi.

Table with 15 columns: Nr, Emër, Mbledhësi, Qarku, Profesioni, Pikët. Includes entries for Qarku Berat Mami.

Table with 15 columns: Nr, Emër, Mbledhësi, Qarku, Profesioni, Pikët. Includes entries for Qarku Elbasan Fizioterapist.

Table with 15 columns: Nr, Emër, Mbledhësi, Qarku, Profesioni, Pikët. Includes entries for Qarku Elbasan Mbledhësi.

Table with 15 columns: Nr, Emër, Mbledhësi, Qarku, Profesioni, Pikët. Includes entries for Qarku Elbasan Infermier.

Table with 15 columns: Nr, Emër, Mbledhësi, Qarku, Profesioni, Pikët. Includes entries for Qarku Elbasan Infermier.

Divja e skenës shqiptare merr vendimin e papritur

Adelina Ismaili lë muzikën për politikën, ja si qëndron e vërteta

"Kënga për Uliksin do jetë e fundit"

Egla Xhemali

Gjithçka nisi pas performancës së saj në "E Diell". Spektakli që dhuroi pas 6 vitesh mungese, në studion e "E Diell" në Top Channel, divja e muzikës shqiptare Adelina Ismaili, do të mbahet mend gjatë për spontanitetin, batutat, energjinë dhe originalitetin e saj. Në fund të performancës muzikore që ajo dhe moderatorja Fjoralba Ponari realizuan së bashku në skenë duke kënduar disa prej hiteve të saj më të bukura ndër vite, Adelina Ismaili dha një deklaratë që i futi në dyshim të gjithë. "Kënga për Uliksin është vetëm e imja dhe ka mundësi që të jetë e fundit publike, por nuk e di, është gjithçka relative", ka habitur ajo. Edi Manushi, Fjoralba Ponari dhe Ervin Kurti dhe me miratimin e publikut në sallë, i shprehën asaj dëshirën për të mos u tërhequr nga muzika. Adelina e gjendur ngushtë në skenë, "u detyrua" ta rimendonte vendimin e saj



duke e lënë ende të hapur si alternativë. Pas deklaratës së saj në spektaklin e së dielës këngëtarja vazhdoi t'i habisë fansat duke i shtuar edhe më dyshimet për një ikje të beftë nga bota e muzikës. Shumë prej mediaeve rozë aludojnë


se bukuroshja nga Kosova po largohet nga pasioni më i madh që ajo ka për t'i hyrë politikës. Ajo që i ka nxitur më tepër ata ka qenë një postim në rrjete sociale, i bërë vetë nga Adelina, në të cilin tregon një video ku ka dhënë mendi-

min për Ushtrinë e Kosovës. Videoja e shpërndarë në 'Facebook' ka marrë 927 komente dhe 12.322 reagime, gjë që ka bërë Adelinen të bëjë një deklaratë të papritur. "Uau! Kaq shumë reagime vetëm se tregova një pikëpamje politike. A duhet të kandidoj për presidente?", shkroi këngëtarja në 'Instagram'. Përveç hiteve ritmike, Adelina ka prekur shumë fenomene politike me anë të muzikës së saj. Madje bëri dhe një këngë të titulluar "Ushtrinë time do ta bëj", të cilën ia dedikonte ish-presidentit të ndjerë, Ibrahim Rugova. Nuk i dihet asnjëherë cila do jetë zgjedhja e artistes nga Kosova, megjithatë, një gjë është e sigurt, Adelina ka ende shumë për t'i dhënë skenës!



Pas sherrit me Noizyn, Oriola Marashi ka diçka për t'iu thënë fansave

Oriola Marashi dhe Noizy kanë prishur raportet ditët e fundit, madje nuk e ndiqnin njëri-tjetrin në 'Instagram'. Por, përmes një 'Instastory', reper i ka zbuluar se çfarë ka bërë Oriola, e cila filloi ta ndjekë sërish reperin dhe ai ia ktheu. "Kaq ishte", ka shkruar Noizy mbi foton ku e tregoi me fakte se modelja i ka bërë "follow" atij. Në vijim, ka reaguuar edhe bukuroshja Marashi, duke postuar në 'Instastory' një foto ku shfaqet krahu Noizy-it, teksa ka mbishkruar: "Një vit më parë në ditëlindjen e Elvana Gjatës dhe promovimin e albumit EP '3!' Po ashtu, Oriola ka shpërndarë në 'Instastory' një poster të Noizy-t, i cili do të performojë në një nga klubet e Tiranës dhe shkroi: "Ju e dini çfarë do ndodhë". Pra, kjo mosmarrëveshje mes Noizyt dhe Oriolës ka marrë fund dhe modelja ka vazhduar të mbështetë reperin në karrierën e tij profesionale.




Turi dhe Orinda për herë të parë prindër? Moderator i zbulon të fshehtën

Një foto e Turjan Hyskos në 'InstaStory' sot ka shkaktuar një furtunë të vërtetë. Të gjithë fansat menduan se ai po dërgonte mesazhe të qarta se çifti ishte në pritje të një fëmije. Duke qenë se ata kanë një kohë të gjatë së bashku kjo do të ishte gjëja më natyrale, por Turjani dhe Orinda kanë mohuar çdo gjë. Në një 'Instastory' tjetër producenti dhe moderatori ka sqaruar çdo gjë: "Nuk kam fshehirë gjë! Është story 24 orë. S'ka asnjë mesazh të fshehur! Është 'këpuca' e Arliit, një shokut tim 6-mujorsh! Ndërkohë Orinda Huta ka dhënë një deklaratë për tيرانapost.al "Kemi qenë në fundjavë me miqtë tanë që kanë fëmijë, e njëri prej tyre është 6-mujorsh! Ne mund të hedhim poshtë çdo aludim për momentin, por ethe e pritjes ende qëndrojnë dhe ne i urojmë sa më shpejt një fëmijë një prej çifteve më të këndshëm të show bizz-it.



Nuk e paskemi ditur! Kejvina bën deklaratën e papritur: Jam e ve!

Ajo është një nga femrat më të bukura e më seksi të show bizz-it shqiptar. Që me daljen e saj të parë, Kejvina Kthella tërhoqi vëmendjen e të gjithëve si dhe ngjalli reagime të shumta. Ajo është kthyer në një nga vajzat më të komentuar dhe çdo e re rreth modeles përbën interes për publikun. Kejvina është mjaft aktive në profilin e saj në "Instagram", aty ku publikon foto e video seksi dhe provokuese. Por shpesh herë bëhet pjesë e opsionit "pyetje-përgjigje", nëpërmjet të cilit i përgjigjet pyetjeve që i drejtojnë fansat. Së fundmi e kanë pyetur nëse është e martuar dhe përgjigja e saj ishte epike: "Në fakt, s'e di njëri, por unë jam e ve" ka thënë Kejvina, sigurisht në kuadër të shakasë.



"Gjyshja ime i ka më të mira", Enca lë pa fjalë me përgjigjen epike

Enca Haxhia nuk është vetëm një nga këngët e artet më të pëlqyera, ndër personazhet më të ndjekur në 'Instagram', por, gjithashtu, edhe ndër më të komentuarit. Së fundmi, bukuroshja ka publikuar një foto shumë të nxehtë ku shfaqet me të brendshme të kuqe mbi një mashkull që me siguri është modeli portugez i klipit "DUA". Dhe vetë Enca në foton e publikuar shkroi "Breaks the internet". Por teksa tregonte në 'Instastory' se disa prej fansave të saj nuk kënaqeshin kurrë, pasi e kritikonin edhe kur dilte e zhveshur, edhe kur vishej, këtë e ilustroi në mënyrë perfekte me bisedën e një ndjekësi. "Gjyshja ime i ka më të mira, besomë",- i shkruante ndjekësi për të pasmet të cilat i kishte ekspozuar në një foto në 'Instastory'. "A ja sheh shpesh by... gjyshes"- ja ka thyer Enca ndjekësit, i cili ka nisur të qeshë me përgjigjen epike.



Para udhëtimit në Amerikë, Haradinaj takon presidentin e Kosovës

Hashim Thaçi: Miqësia me SHBA-në dhe vlerat perëndimore, përkushtim i shtetit tonë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi është nisur për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku do të marrë pjesë në 'Lutjet e Mëngjesit'. Lajmin e ka bërë të ditur vetë presidenti, përmes një postimi në Facebook. Thaçi shkruan se miqësia me SHBA-në dhe vlerat perëndimore do të jenë përjetësisht përkushtim i Kosovës. "Sapo u nisa për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku bashkë me liderë të shumtë botërorë



HASHIM THAÇI

"Sapo u nisa për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku bashkë me liderë të shumtë botërorë do të marrë pjesë në Lutjet e Mëngjesit. Miqësia me SHBA-në dhe vlerat perëndimore do të jenë përjetësisht përkushtim i Republikës së Kosovës", - shkruan Thaçi.

do të marr pjesë në Lutjet e Mëngjesit. Miqësia me SHBA-në dhe vlerat perëndimore do të jenë përjetësisht përkushtim i Republikës së Kosovës", shkruan

Thaçi. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka pritur dje në një takim Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Ka qenë vetë Haradinaj, ai që e ka ndarë takimin përmes një postimi në faqen e tij të Facebook', ndërsa shprehet se takimi me presidentin Thaçi është në vazhden e konsultimeve për agjendë shtetërore. "Në vazhden e konsultimeve për agjendën shtetërore, prita në takim Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, para udhëtimit të tij në ShBA", - shkruan Haradinaj.

Burime nga BE: Me heqjen e taksës nisin direkt bisedimet me Serbinë

Bashkimi European: Është koha për marrëveshje Prishtinë-Beograd

Dialogu me Kosovën, Vuçiq shton të tjera kushte

Edhe pse vijnë ndërrhyrjet e herëpashershme të zyrtarëve të Bashkimit Evropian për të arritur në një marrëveshje në dialogun Kosovë-Serbi, ende nuk është arritur në një pikë takimi mes dy shteteve. Të përfshirë në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me kujdes, zyrtarët të BE-së po përcjellin zhvillimet në Prishtinë, por shpresojnë se presioni i shumëfishtë ndaj qeverisë do të tregojë shumë shpejt rezultate në mënyrë që të mundësohet zhblokimi i procesit të dialogut. Burime nga kabineti i Përfaqësueses së Lartë, Federica Mogherini, kanë konfirmuar se në momentin e heqjes së tarifës ndaj mallrave serbe nga ana e Prishtinës, ata janë të gatshëm që "praktikisht të nesërmen" të vazhdojnë me procesin e bisedimeve. Në këtë drejtim, paralajmërohen bisedime intensive ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit të cilat do të mund të mbahen çdo javë. Zyrtarët evropianë e pranojnë se BE-ja nuk ka krijuar kurrë një "lidhje formale" ndërmjet tarifës dhe dialogut, por megjithatë ajo lidhje ekziston pasi pala serbe nuk ka mundësi të bindet për tu kthyer në tryezën e bisedimeve derisa vendimi i qeverisë së Kosovës për tarifën mbetet në fuqi. Në anën tjetër, sipas këtyre zyrtarëve të BE-së, tarifa e vendosur nga autoritetet në Prishtinë është "kundërproduktive". Ata thonë se vendimi dymujor për tarifën e mallrave të importuara nga Serbia dhe Bosnja ka prekur edhe kompanitë evropiane që janë aktive në rajon. Duke reflektuar mbi zhvillimet më të fundit në skenën politike të Kosovës, zyrtarët evropianë shpresojnë se presioni i përbashkët i Brukselit dhe Uashingtonit mbi qeverinë e Kosovës do të tregojë rezultate. Por, sipas tyre, mundësia e mbajtjes së zgjedhjeve në Kosovë, do të ishte për BE-në "skeneri më i keq". Zgjedhjet e reja nënkuptojnë një pengesë të re në dialog. Askush nuk e dëshiron këtë sepse jemi nën presion të madh të kohës, tha një burim diplomatik për Shërbimin e Ballkanit të Radios 'Evropa e Lirë'. Në këtë drejtim, Prishtinës dhe Beogradit iu dërgo-



Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, Federika Mogherini

het porosi se, nëse duan një zgjidhje, tani është koha për të, sepse "koha po afron". Ky paralajmërim ka të bëjë me faktin se institucionet e BE-së janë në vitin e zgjedhjeve dhe se aktualisht në zyrat kyçe janë ata politikanë që "sinqerisht duan të zgjidhin përfundimisht çështjen e Kosovës dhe Serbisë". "Nuk e dimë kurrë se çfarë do të jetë rezultati i zgjedhjeve evropiane dhe kush do të marrë përsipër funksionet që kanë të bëjnë me Ballkanin Perëndimor. Ne nuk jemi të sigurt nëse përfaqësuesit e ardhshëm të BE-së, do të jenë kaq të përkushtuar sikurse janë komisionerët aktualë (Mogherini dhe Hahn)", -tha një burim diplomatik. Ndërkohë që pas kush-tëzimit të dialogut me heqjen e taksës, shteti serb vazhdon të zgjerojë pretendimet me kushtëzime ndaj Kosovës.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq ka deklaruar se negjca aktuale e dialogut mund të tejkalohet vetëm kur Prishtina ta heq taksën 100% për mallrat nga Serbia. Sipas tij, dialogu mund të vazhdojë kur Prishtina, siç tha ai, të ndalë provokimet, e në veçanti tentimit për t'ia ndërruar statutin Treptëç që vlerëson se është rëndësi i pronës serbe. Në komunikatën e lëshuar për media pas takimit me ambasadorin e Britanisë së Madhe në Beograd, Denis Kiff, Vuçiq ka thënë se Serbia gjithmonë do të jetë e përkushtuar për paqe dhe stabilitet në rajon. Presidenti serb ka falënderuar Kiff për përkrahjen që vendi i tij i ka dhënë Serbisë, si dhe ka folur për dëmet që i janë shkaktuar Serbisë nga taksat e vënë njëanshëm nga Prishtina, për mallrat serbe që sipas tij rrezikojnë dialogun në Bruksel.

SHKURT
Ballkan,
shtohen viktimat
e gripit

Vendet ballkanike dhe Italia janë në situatë emergjence nga virusi AHINI. Situatë problematike shfaqet në Rumani ku është thelluar në 72 bilanci i të vdekurve. Tre persona kanë humbur jetën gjatë orëve të fundit në këtë vend që ka shpallur gjendjen e epidemisë. Viktima janë regjistruar edhe në Itali, Kroaci, Bosnje, Greqi, Mal të Zi e Bullgari. Edhe autoritetet në Marok flasin për 11 të vdekur nga ky virus. Shifra totale e viktimave në këto vende ka arritur në 224.

Vetëvendosje:
Haradinaj ia ka dorëzuar
kompetencat Thaçi

Shefi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca deklaroi se kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pranuar se po heq dorë nga dialogu Kosovë-Serbi, pasi sipas tij është "matematikë e komplikuar për të". Sipas Konjufcës, kryeministri Haradinaj ia ka dorëzuar kompetencat presidentit Hashim Thaçi pasi nuk mund të përballlet me të. "Haradinaj nuk po mundet të përballlet me presidentin Thaçi, po i lë gjërat në gjysmë karshi tij. Krijimi i ekipit negociator është një hap i gabuar ndërsa marrëveshja finale me Serbinë është arritur por presidenti Thaçi nuk po tregon se çfarë përmban ajo", tha Konjufca. Sipas tij, Mogherini ka thënë se të dy presidentët janë pajtuar shumë mes tyre po se për çfarë Thaçi nuk informon. Këto deklarata Konjufca i bëri në tryezën e organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) me temën "Dialogu Kosovë Serbi - Vit i Ri, Sfidë e Vjetër".

Maqedoni, gjykata ngrin pasuritë e 4 ish-ministrave

Gjykata e Shkupit me kërkesë të Prokurorisë për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit ka ngrirë pasuritë e katër ish-ministrave. Ish-ministrat Mihail Cvetkov dhe Hristijan Dellev kanë përfunduar në paraburgim, ndërsa ish-ministri Aco Spasenovski për shkak të gjendjes shëndetësore është në arrest shtëpiak. Për Ljupçko Dimovskin gjatë javës së ardhshme do të mbahet seancë për kërkesën për paraburgim, pasi Kuvendi ia mori mandatin e deputetit. Më herët, prokuroria hapi një çështje kundër tyre bazuar nën dyshimet se kanë kryer veprën penale "keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe kompetencave gjatë shpalljeve publike". Ata dyshohen se gjatë kohës së ministria të Bujqësisë, kanë nënshkruar marrëveshje për dhënie me qira të tokës bujqësore shtetërore dhe në këtë mënyrë e kanë dëmtuar buxhetin e shtetit për mbi 1.4 milionë euro.

TAKIMI KOSOVË-SHQIPËRI, DISKUTOJNË TAKSËN NDAJ SERBISË



Mbrëmjen e të dielës presidenti Thaçi e kryeministri Haradinaj kanë darkuar bashkë, ku prezent ishin edhe kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, kryeparlamentari Veseli dhe zëvendëskryeministrat Pacolli e Limaj. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se të presidenti ishin për t'ia uruar shtëpinë e re.

FOTOLAJM

Maduro: Një "Vietnam i dytë", Trump do njolloset me gjak "Sovraniteti nuk diskutohet, mbrohet", Venezuela u kundërpërgjigjet SHBA-ve

Nëse Trump merr pjesë ushtarakisht në Venezuelë, do të jetë përgjegjës për një gjakderdhje të ngjashme me luftën e Vietnamit. Këtë gjë e ka paralajmëruar Nikolas Maduro ditën e djeshme. Në një intervistë me gazetarin spanjoll Jordi Évole, presidenti i Venezuelës komentoj deklaratat e Trump për një ndërhyrje të mundshme ushtarake kundër Karakasit. "Stop! Stop, Trump! Mbjajeni atje! Ju jeni duke bërë gabime që do të lënë duart tuaja të mbuluara me gjak dhe do të largoheni nga presidenca e ngjyrosur me gjak", tha Maduro. Ai paralajmëroi se një luftë e mundshme mund të nënkuptonte një "Vietnam" të ri për Uashingtonin. Në një deklaratë të mëparshme,



presidenti amerikan ka përjashtuar çdo negociatë, duke pohuar se dërgimi i ushtrisë amerikane në Venezuelë ishte thjesht "një opsion". "Nëse perandoria amerikane e veriut na sulmon, ne do të du-

NIKOLAS MADURO

"Stop! Stop, Trump! Mbjajeni atje! Ju jeni duke bërë gabime që do t'ua lënë duart të mbuluara me gjak dhe do të largoheni nga presidenca të ngjyrosur me gjak. Nëse perandoria amerikane e veriut na sulmon, ne do të duhet të mbrojmë veten. Nuk do ta dorëzojmë Venezuelën. Ne kemi edhe sekretet tona", tha Maduro.

het të mbrojmë veten. Ne nuk do ta dorëzojmë Venezuelën. Ne kemi edhe sekretet tona", tha presidenti venezuelian. "Venezuela do të qëndrojë e gatshme për të zbrapsur një sulm ushtarak sa herë që të jetë e nevojshme", tha zëvendës-presidentja Delice Rodriguez. Përgjigja e Rod-

rigues vjen si kundërpërgjigje ndaj Presidentit Donald Trump, i cili tha se një ndërhyrje ushtarake në Venezuelë është "një opsion". Duke folur për mediat ruse të dielën, Rodriguez tha se Venezuela e konsideron vërrejtjen e Trump si "të papranueshëm". "Nëse një sulm do të ngrihet mbi sov-

ranitetin e vendit, ushtria dhe njerëzit e saj janë plotësisht të përgatitur për t'u hakmarrë", theksoi ajo, duke e quajtur çështjen e pavarësisë së vendit të pnegociueshme. "Sovraniteti nuk diskutohet, mbrohet", theksoi ajo. Rodriguez shtoi se populli i Venezuelës do të jetë në gatishmëri për të mbrojtur kufijtë e vendit dhe nuk do të lejojë asnjë ndërhyrje të huaj, pavarësisht nga vjen. "Ne jemi gjithmonë të gatshëm për të shmanjur një sulm". Rodriguez nuk ka specifikuar nëse Karakas kishte ndërmarrë ndonjë hap shtesë për të përgatitur vendin për një sulm potencial ushtarak, siç është përforsimi i kufirit, duke vënë në dukje se të gjitha këto pyetje duhet t'i drejtohen Kolumbisë, një aleat i SHBA në rajon, e cila po e bën këtë.



10 skiatorë të vdekur, pas një vale ortekësh në alpe

Këtë fundjavë 10 skiatorë kanë humbur jetën, ndërsa një tjetër është shpallur i humbur në alpet italiane, franceze, zvicerane dhe austriake, ku ortekët kanë qenë të shumtë. Bilanci më i rëndë vjen nga Vale D'Aosta, në veriperëndim të Italisë, ku pesë persona kanë humbur jetën dhe një prej tyre është zhdukur. Ndërkohë në stacionin e Courmayeurit, tre turistë janë gjetur të ngrirë në borë. Në Bolzano, një djalë 18-vjeçar i zënë nga një ortek pranë kufirit italo-austriak u gjet i asfiksur nën dëborë. Gjithashtu, ka pasur viktima edhe në Zvicër, ku një ortek u ka marrë jetën dy personave. Situa është më kritike në Itali, ku ortekët kanë bllokuar për disa kilometra një autostradë, duke shkaktuar trafik të jashtëzakonshëm.

"BBC": Kërkimet nënujore gjejnë pjesë të avionit "Piper Malibu"

Gjendet një trup në aeroplanin ku udhëtonte futbollisti Sala

Zhdukur prej dy javësh, zbulohen mbetjet nën ujë

Ditën e djeshme është gjetur një trup i pa jetë në rrënojat e aeroplanit me të cilin udhëtonte futbollisti Emiliano Sala. Trupi i pajetë u zbulua në brendësi të avionit të rrëzuar në thellësinë e detit, raporton "BBC". Pjesë të aeroplanit u gjetën të dielën gjatë kërkimeve nënujore. Autoritetet kanë konfirmuar se kanë gjetur një trup brenda rrënojave të avionit, por nuk ka informacione nëse i përket futbollistit 28-vjeçar apo pilotit Dave Ibbotson. Deri tani nuk ka asnjë të dhënë për trupin e dytë të pajetë. Rrënojat nën ujë të avionit "Piper Malibu" u zbuluan nga kërkimet me mjete të automatizuara. Ndërkaq, autoritetet nisën një kërkim nënujor pas zhdukjes së futbollistit. Dega e Hetimit të Aksidenteve Ajrore së bashku me një anije private kryen kërkime nën ujë për të gjetur pjesë të avionit të vogël. Kërkime zgjatën 3 ditë. Futbollisti Emiliano Sala ishte në bordin e avionit të vogël, që u zhduk dy javë më parë. Ai ishte nisur nga Franca për të shkuar drejt Uellsit. Vetëm para 1 javë, në brigjet veriperëndimore të Francës u gjetën disa sedilje, që besohet se i përkisnin avionit të zhdukur. Lajmi për gjetjen e mbetjeve është bërë i ditur nga Agjencia Britanike e Hetimit të Aksidenteve Ajrore. Më parë kushtet e këqija të motit penguan ekipet e kërkimit që të kryejnë kontrollin të imtësisht. Para përplasjes, Sala kishte lënë një mesazh zanor që ua kishte dërguar shokëve të tij, ku thoshte se kishte frikë. Një mesazh prekës nga motra e Emiliano Salës erdhi vetëm dy ditë pas zhdukjes së tij. Romina, mes lotëve, bëri thirrje publike që kërkimet për të gjetur vëllain e saj të vijojnë. Pasi firmosi lëvizjen me klubin e "Cardiff City" mbrëmjen e së



Futbollisti Emiliano Sala

premtës të 18 janarit, për një shifër rekord prej 15 milionë paundësh, Sala u nis nga Franca drejt Uellsit në bordin e një avionit të vogël "Piper Malibu", që besohet se u rrëzua në Ishujt e Kanalit, mbrëmjen 21 janarit. 28-vjeçari dhe piloti David Ibbotson ishin të vetmit persona në bordin e avionit, që pavarësisht kërkimeve të shumta, nuk janë gjetur ende. Policia e Guernsey ndërpreu përfundimisht kërkimet mbrëmjen e së enjtes, duke e konsideruar mundësinë që ata të gjenen gjallë thuajse të pamundur. Motra e Sala, Romina Sala udhëtoi drejt Kardifit dhe përballë mediave në hotelin "St.David" të kryeqytetit të Uellsit u bëri apel au-

toriteteve që të mos hiqnin dorë. "I kuptojmë faktet dhe vlerësojmë sinqerisht përpjekjet tuaja. Duam të falënderojmë të dyja klubet (Cardiff dhe Nantes) dhe të gjithë ata që po kërkojnë për Emiliano, por mesazhi im është ju lutem, lutem mos i ndaloni kërkimet! Për mua, ata janë ende gjallë. Nuk e kam të lehtë të shpreh ndjenjat e mia në këtë moment, sepse është shumë e vështirë", tha e reja mes lotëve. "Kemi pasur shumë mbështetje nga të dyja klubet dhe falënderoj të gjithë fansat për përpjekjet e tyre, por thellë në zemrën time e di që Emiliano, i cili është luftarak, është ende gjallë. E di që Emiliano dhe piloti janë diku në mes të kanalit.

Ne nuk do të dorëzohemi". "Pyetjet janë për një tjetër moment. Tani janë dy familje të dëshpëruara për të ditur fatin e dy njerëzve. Pyetjet sesi hipi Emiliano në avion dhe çfarë ndodhi janë për një tjetër moment, jo tani. E vetmja gjë që dua është të gjej tim vëlla dhe ta shoh atë sërisht", ka thënë Romina Sala mes lotësh. Avioni i vogël me të cilin udhëtonte Emiliano Sala nga Franca drejt Uellsit u zhduk mbrëmjen e 21 janarit. Alarmi u dha pas humbjes nga radarët dhe pas ndërprerjes së komunikimit në radio. Natën që aeroplani u rrëzua, kushtet atmosferike kanë qenë të këqija. Para rrëzimit, Emiliano Sala kishte dërguar mesazh zanor të shokët e tij.

Ministri gjerman: Penalizim për azilkërkuesit që gënjejnë

Horst Seehofer, ministri i Punëve të Brendshme të Gjermanisë, ka thënë se nëse azilkërkuesit e refuzuar fshehin identitetin, do të humbasin "duldung"-un, lejen e përkohshme të toleruar. Planet janë ende duke u përgatitur. Agjencia e lajmeve AFP dhe gazeta "Die Welt" citojnë një draft të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Berlin: "Kush e pengon dëbimin, duke u dhënë të dhëna të gabuara autoriteteve për identitetin apo nënshtetësinë, ose nuk ndihmon në sigurimin e pasaportës, nuk do të marrë në të ardhmen më "duldung" (lejen e përkohshme të toleruar të qëndrimit). Ky i huaj do të pajiset vetëm me një leje që shënon se ai është i detyruar të largohet nga Gjermania", raporton gazeta "Die Welt". Synimi i këtij ashpërsimi ligjor është të ndahen azilkërkuesit e refuzuar që e pengojnë vetë dëbimin e tyre nga ata, që për arsye të njohura nuk mund të dëbohen, sepse nuk kanë pasaportë, kanë arsye të forta humanitare, që flasin kundër dëbimit apo në rajonin e banimit të personit nuk ka fluturime për shkak se është një rajon krize. Një zëdhënës i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Berlin është shprehur se azilkërkuesit janë deri më tani i vetmi grup i të huajve në Gjermani, i cili nuk ndiqet penalisht kur gënjën autoritetet për identitetin. Aktualisht ka vetëm gjobitje si kundravajtje. Kjo është një gjendje që nuk duam ta pranojmë më si të tillë". Për të mbyllur këtë boshllëk ligjor penalizimi po zhvillohen diskutime në nivel ekspertësh thuhet nga Ministria e Punëve të Brendshme. Por, aktualisht ky projektligj ende nuk është akorduar me sektorë të tjerë të ministrisë, prandaj është shumë herët të ofrohen të dhëna më konkrete. Po ashtu nuk dihet nëse partitë e koalicionit do të binin në ujd për një ligj të tillë. Ministria socialdemokrate e Drejtësisë, Katarina Barley, ka shprehur rezervat për propozimin e Seehoferit. Një zëdhënës tha se kur projektligji të jetë gati, ai do të shqyrtohet, por tani të dhënat e gabuara personale shihen si kundërvajtje dhe gjobiten. Organizata e të drejtave të njeriut, "Pro Asyl", i kritikon planet e Seehoferit. "Praktika tregon se azilkërkuesve shpesh në mënyrë arbitrare u thuhet se nuk bashkëprojetojnë sa duhet. Në një kohë që ka arsye të ndryshme për dokumentet që mungojnë", shpjegon "Pro Asyl".

LETËRKËMBIMET

Në gjurmët e Pater Gjergj Fishtës, letërkëmbimi dhe një foto e panjohur

Në numrin e tij të fundit "Hylli i Dritës" sjell një letërkëmbim të Gjergj Fishtës me ambasadorin shqiptar në Bari më 1934 dhe shënimin e studiuesit Alessandro Serra për një foto të panjohur të At Gjergj Fishtës.

Letrat e këmbyer mes Fishtës dhe Gjon Kamsit janë pjesë e arkivit dhe bibliotekës që familja Kamsi i dhuroi Bibliotekës Françeskane sipas amanetit të Villy Kamsit.

Kujtojmë, së pari, se pjesëtarët e familjes Kamsi e kishin tejet të zhvilluar andjen për shkëmbimin e letrave, me shumë rëndësi për shkëmbimin e mendimeve e zgjidhjen e problemeve të ndërlikueme të kohës. Shpesh letërkëmbimi ka vlera të pallogaritshme, sepse ndihmon për ta shkruar e, sidomos, për ta rishkruar historinë, kur prej saj mbetet vetëm keqeshkronja.

LETRA E FOTO

Po ece në gjurmët e Pater Gjergj Fishtës, nëpër mija shtigjet ku i shkeli kamba, do të zbulosh gjithnjë shkëndija të reja, që vijojnë të shkrepitjnë prej gjenisë së Tij. Ecje, që duhet vijue, sepse rruga e përshkueme prej Fratit-Poet asht shumë e gjatë e edhe e pashkelun... Këtë herë na çoi në arkivin e pasun të familjes Kamsi - sapo dhurue bujarisht françeskanëve. E atje, ndërmjet shumë vlerave të tjera, gjetëm një letër e një fotografi të panjohur të At Gjergj Fishtës, mendon se asht e fundmja...

Po kush asht Alessandro Serra? Alessandro Serra, arbëresh, lindin në Spezzano Albanese, në vitin 1912, vdiq në Romë, në vitin 2000. Qe profesor e studiues i historisë. U interesue shumë për mbledhjen dhe rruetjen e dokumenteve lidhur me historinë dhe kulturën e italo-shqiptarëve. Bashkëpunoi me revistën "Shëzjat" dhe "Katundi ynë", si dhe me një mori gazetash italiane, kryekrejt me gazetën vaticane "L'Osservatore Romano", me "Il Tempo"; "Storia illustrata"; "Calabria Letteraria" etj... Veprat e tij ma të njohuna janë: "Spezzano albanese nelle vicende storiche sue e dell'Italia (1470-1945)" [Speccano shqiptar në ngjarjet historike të veta e të Italisë (1470-1945)]; "Albania 8 settembre '43 - 9 marzo 1944" [Shqipëria 8 shtator '43 - 9 mars 1944]; "I profughi dell'Albania verso l'Italia ospitale" dhe, së fundi, "Shqipëria e Skënderbeut dhe Papët për mbrojtjen e perëndimit të krishtenë". [L'Albania di Scanderbeg e i Pontefici per la difesa dell'occidente cristiano" (1444-1468)], botue në Cosenza në Casa del Libro", 1960. Kushtimi në krye të veprës, me një

"Hylli i dritës" nxjerr dokumentet që familja Kamsi iu dhuroi françeskanëve



Pater Gjergj Fishta

tingëllim të fuqishëm aktual, të kujton situatën e trazue me të Shqipnisë në shekuj: "Shqiptarëve të Shqipnisë e atyne që jetojnë të shprishun nëpër botë, me urimin që këto faqe t'u sjellin sadopak qetësi në zemrat e tyre të trazueme, Alessandro Serra".

LETRA E ALESSANDRO SERRËS - VILLY KAMSIT

Romë, 18 prill 1934

Zotit Ambasador të Shqipnisë Romë Në vitin 1940, ndërsa jepshë mësim në liceun e Shën Dhimitër Koronës (në Kozencë), u thirra nën armë dhe u caktova në Komandën e Armatës së Tiranës. Në tetor, shkova në Shkodër, për t'i bënë një vizitë poetit Pater Gjergj Fishta, për të cilin shkrova edhe një artikull, që ma vonë e botova në gazeta e revista. Po i bashkangjës letrës edhe artikullin, nga i cili mësohet se mbas bisedës, i bana edhe fotografimin, e fundmja e jetës së tij. Ai, nga ana e tij, më dhuroi të mahnitshmen "Lahutë të Malcis". Tashti dëshiroj të di me hollësinat përkatëse, fatin zyrtar që patën eshtënt e Poetit të madh në

kohët ogurzeza të Enver Hoxhës. I sigurt se po baj dicka, që ju pëlqen, po e bashkangjës edhe kopjen e fotografisë, ndërsa ju dërgoj librin tim të fundit mbi Shqipninë, nga e cila ulargova në mars 1944, së bashku me tetëqind italianë. Biblioteka Kombëtare e Tiranës i ka librat e mi. E hap historinë e vendit tim, një studim interesant mbi marrëdhëniet e Gjergj Kastriotit Skanderbeg me Papët e kohës tij. Gjithnjë tue i urue gjithë të mirat Shqipnisë së dashun, ju dërgoj përshëndetjet e mia ma të përzemërta.

Firma: Prof Alessandro Serra Viale Rousseau n. 97 00137-Roma Përsa i përket fotografisë, shita het kjarhtë se asht Pater Gjergj, i shtymë në mot - por ende i kërtëneshtë. Pëtyra e tij, plot me jetë, premtun vepra të reja. Nuk na bind, prandaj se asht e fundmja. Tue pasë parasysh edhe se e fundmja asht ajo në shtratin e vdekjes - me bashkëvëllazrit pranë. Për të mos kujtue maskën mortore, realizue nga frati jezuit Sala gjatë funeralit madhështor, të cilin ia kish-

te borxh Atdehu. Kjo - një gjurmë... Po duhet të ketë edhe shumë të tjera, të cilat shpresojmë të kërkohen, e të gjinden...

LETËRKËMBIMI

Po botojmë disa letërkëmbime të At Gjergj Fishtës me Gjon Kamsin.

Letërkëmbimet kanë një randësi të posaçme, sepse hedhin dritë mbi dëshirën e Poetit tonë për të botue veprat e tij në Itali në shtypshkrojet "La Terza". Kësisoj, në një letër tjetër, At Gjergj Fishta lyp kornice për pinakoteken e tij. Sigurisht, këto informacione shërbejnë për të ndërtue jetëshkrimin e At Fishtës. Në fund kemi vendosë edhe telegramin që Gjon Kamsi dërgon Provincialisit të asaj kohe At Ciprijan Nikes me rasën e vdekjes së At Gjergj Fishtës. Letrat janë pjesë e arkivit të bibliotekës së Gjon dhe Eilly Kamsit, dhurue nga Myriam Kamsi Provincocës Françeskane Shqiptare.

S. Bartolomeo all'Isola 12-XI-25

I dashtuni Gjon, M' bähët se na kë pasë shkruë një herë, se ká metë ka ti një kuti cingaresh, qi na ká pasë dergue P. Matija prej Shkodre. Per në kjoftë se asht gjá kso fjale, të lutem me ma dergue kutin m' adresë: Legazione Albanese-Roma: pse jam marrë vesh me sekretarin per ket punë. Dër m'sod unë s'kam marrë letre prej Shqypnije. M'shkruej, për në diejsh gjá mbi të mrrime të P. Palit e t'Ambrozit, si edhe t'Arqipeshkvit në Shkoder. U falem me shndet tyë edhe Rozës.

P. Gj. Fishta.

Shkodër, 18 Prill 1931

I Nderiti e i dashtuni Gjovalin, Kúr të kthej P. Vinçenci në Bari, të lutem me i thánë prej anes s'eme, qi po i pá gjasen - të na blëj 25 metra kornice arit jo të trasha por as tepra të holla, e nja 13 metra të trasha, për piktura qi kemi bashkue per pinakatekë (!). Mbasi janë per "kishë" kshtu hinë pa doganë. Për në mújsh me m'i a mújshë menden per ket punë, atëherë thuej, qi t'a qesë edhe një kafë prej anës s'eme ...

U falem me shndet të gjithve P. Gjergj Fishta ofm.

Livorno, 1 Máj 1934 12, Via delle Galere

I dashtuni Lin, Dishroj me botue - per në paça me se' - veprat e mija të gjitha në nji masë e në nji trajtë. Të gjith vepra kishte me pershi shtatë volume në XVI" kah 350 faqe in media per secillin. Gjashtë kishin me këné në poezi, e nji - kund 600 faqesh - në prozë. Botimin



kishe m'e dashtë, si të thashë, formato "decimosesto", germa e leter si nder botime klasike të Romagnoli-t, botue prej shtypshkrojet "Laterza" në Bari. Fol pra, të lutem, me "Laterzen": per sa Lit. kishte me m'a botue nji sedicesimo - poesia e prosa in lingua albanese, con tipi e carta identici alle edizioni classiche del Romagnoli; il tempo che impiegherebbe per l'edizione dei sette volumetti e quali sarebero le condizioni del versamento del denaro da parte mia. Ogni volume dovrebbe esser tirato in mille copie. Edhë më shkruet me nji herë. A e k' marrë nji leter të porositne, qi të pata dergue para do javësh ? Të falem nderës per urime, qi më ke dergue me rasë të ditës s'ëmnit t'ëm. Të shterngon doren me shum shndete


P. Gjergj

Egregio Signore Sig. Giovanni Kamsi - 25, Via Imbriani - Bari Livorno, 16.5.34

I dashtuni Gjovalin ! Sod mbas-dite t'a nisa librin - Anzat e Parnasit - per të cillin më shkrueshe në të mbramen leter t'ande. Më pelqen Corpo 10 Bodoni (f. 5), perdorue prej Mondadori, veç drue mos të jët pak si i vogel per në Shqypetarët - Ti e din se nder në gjindja lexojnë me të vshtirë ! - Po të kishte ajo shtypshkroje Corpo 11 Bodoni, puna do të kishte dalë teste. Me gjith kta do të mërremi veshit prap mbi ket gjasend. Të falem nderës per broshuren "Albania". Ishte shkruë pernjimend mire. Sa per



punë të letrës me date 1. e impostue me 7, do të kemë gabue vetë në datë; pse sugurisht nuk ka kënë impostue para 7 të k.m. Kë me më bë një nderë, per në më dergosh gjegjen miqve t'ue mbi shka të sh-



krueshe në leter të porositne, si edhe lajmet qi më premtan në leter t'ande. Tue t'u falë nderës per kujdesim të botimit të libravet të mij, të falem me shndet shi prej zëmret.

P. Gjergji P.S.

Per n'u bafë puna qi me botue librat e mi n'at shtypshkroje, kam me lutë Provincjalin, qi të dergoje at? P. Benedikt Dëmen si per qortim të stamponi-ve, si per trajtë të botimit. Idem P. Pali më shkruen, se ti kë mndyren se si me dergue letrat në Shkoder, pa pasë nevojë me i kalue neper Postë: a asht tamand kjo fjalë?

192 Egregio Signore Sig. Giovanni Kamsi
- 25, Via Imbriani - Bari
Para ktyne 4 a 5 ditve t'a kam

shkrue një leter mbi një çashtje, të cillen, mbasi enë s'kam marrë kurrfarë gjegje perkate prej teje, po t'a diftoj rishtas ktu poshtë. Dishroj me rishbotue veprat letrare të mija. Kto vepra kishin me perbà shtatë volumi in XVlo kund 350 faqesh secilli. Pësë kan me kënë në poezi e dy në prozë. Tash m'nterenson me dijte prej shtypshkrojet "Laterza": 1. a kishite me m'i botue kto vepra të gjitha shqyp; 2. per sa kohë kishite me m'i botue; 3. sa Lit. Kishite me më lypë per një sedicesimo në prozë e sa per një në poezi, mbi një leter si ajo e botimevet klasike të Romagnalit; 4. Ç'farë konditash ven per të lām të parevet. Të lutem me më pergjegjë sa mǎ para mbi ket punë. Të shteron doren miqësisht.


P. Gj. Fishta.

LIBRI I LLESHANAKUT NOMINOHET PËR ÇMIMIN 'PEN AMERIKA 2019'

Hapësira negative" i Luljeta Lleshanaku i përkthyer nga Ani Gjika, dhe i botuar nga Shtëpia botuese New Directions në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 2018, nga i nominuar, tashmë është zgjedhur në pesë librat finalistë për Çmimin 'PEN Amerika 2019'. Ky është libri i pestë i autore në gjuhën angleze. Në këtë përmbledhje përfshihen dy librat e botuar në origjinal nga shtëpia botuese "OMBRA GVG": "Pothuajse dje" (2012) dhe "Homo antarcticus" (2015), libra të vlerësuar në Shqipëri me çmimet e "Panairit të Librit 2013", "KULT 2013", dhe "Albanian PEN 2016".

Përkthimi i "Negative space" nga Ani Gjika, cilësohet nga kritika si një përkthim brilant. Ky është konkurrimi i dytë, pasi për botimin në Angli të "Negative space" nga shtëpia botuese 'Bloodaxe', Ani Gjika është vlerësuar më parë me çmimin 'English PEN' dhe me grant nga National Endowment for Arts në SHBA.

"Negative space" tashmë është një nga librat e rekomanduar nga Poetry Society në Angli, Poetry Society në Amerikë, revista World Literature Today, etj. "Lleshanaku ka një talent trullësor në kapjen e shenjave të rrënimt tonë", shkruan Nick Ripatrzone për "The Millions".



IN MEMORIAM

Dy vite pa Dritëroin/ Elona Agolli: Malli për tim atë




Familjarët dhe miqtë më të afërt kanë zgjedhur ta kujtojnë shkrimtarin Dritëro Agolli me një ceremoni të ngushtë në 2-vjetorin e ikjes nga jeta. Familja ndërkohë, ka pranuar që të ndajë copëza nga jeta e Agollit me publikun, teksa Bashkia e Tiranës ka vendosur ta kthejë shtëpinë e tij dhe të Ismail Kadarese në muze.

Në dy vjetorin e shuarjes, e bija, Elona Agolli e kujton Dritëronë me shumë mall.

"3 shkurt 2019. Ç'farë është malli? Të kesh mall? Malli përmbledh ndjenjën e nevojës për të qenë pranë një njeriu të dashur, të afërm. E malli përmbledh nevojën për t'i dëgjuar zërin, për ta parë, për ta prekur, për të folur, për ta ledhatuar. Kur të afërmin e ke diku larg, në distancë gjeografike të largët, malli rritet, por ndërgjegjja i thërret mallit dhe shpresa po ashtu dhe dita kur takohesh, i zbut dhe shuan ato ethe malli që të kanë pushtuar gjatë kohës së mungesës të të afërmit. Po malli për të shtrenjtin, i cili nuk është më në jetë? Me të cilin nuk të ndan distancë gjeografike, por një distancë humbëtare, distancë botësh, botës së jetueshme dhe asaj të pajetueshme?", shkruan Elona në profilin e saj në rrjetin social 'Facebook'. Për të, "malli për babin, për të mirin atin tim, është fare i ndryshëm nga çdo ndjesi malli. Kur ndjej mall kam dhimbje, dhimbje që shoqërohet pavetëdijshëm me një rënkim e shqiptim tingujsh: oh! Nuk ka mundësi të përshkruhet tërësisht ajo që ndjej". Thotë se i duket sikur brenda trupit ka një organ përbërë nga materie të padukshme, por që ka ngjyrën e gjakut e sa herë që malli i thellë e kaplon, ai kullon. E shprehja "më dhemb shpirti", nuk është e rastësishme.

"Është një dhimbje fare e ndryshme nga ajo fizikja. Sot shkuan plot dy vjet. Nata e kaluar plot ëndrra, makth, flakë. Sot e dija që do nisesha herët për të përkujtuar e parë të ftohtë banesë ku tashmë ndodhesh. Kisha nevojë për ajër sot dhe ndërkohë që zbrisja e prisja të nisesha mendueshëm, vrikthi përpara fytyrës, një flutur krahemurrme. Ja, erdhi, sa shpejt u zhduk, ku iku?" Bëja ta kapja e arrija me shikim, por aq, iku... Një flutur e murrme dhe era shkundëse e gjithçkaje, çuditërisht shoqërojnë këtë ditë përpiktazi", thotë ajo dhe kujton se vargjet që recitonin bashkë pasditeve ishin edhe këto "veç dua me gjuhën e erës/ Me erën menduar të flas".

Shkrimtari ndërroi jetë, në moshën 85-vjeçare. Me rastin e 85-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Dritëro Agolli, Akademia e Shkencave i pati dhënë lexuesit në Shqipëri tri dramat e tij: "Fytyra e dytë", "Moshë e bardhë" dhe "Baladë për një grua". Dramat "Fytyra e dytë" dhe "Baladë për një grua"- ato qenë krejt të panjohura për lexuesin deri më sot, kurse drama "Moshë e bardhë" është botuar nga Rilindja në Prishtinë në vitet 1970-1980.



Opinion

Sportiv

Duke lexuar shpirtin pergamen të Skënder Sherifit...!

Ng Përparim Kabo

(vijon nga faqja 1)

... e dallueshëm kishte një shkrim hieroglifesh. Fillimisht nuk e transkriptova dot, kishte një kod magjik. Vijova udhën nëpër faqet ku kishte vetëm poezi... dhe bashkë me këtë udhëtim ikte megjulla mbi shkrimin e vjetër deri sa më në fund doli në dritë një shprehje lakonike, një lloj kontradiksioni logjik tejet provokues. "Jam ai që nuk kam, por e di se çfarë më mungon"... Jam kalorësi i të përkoishmes! Tingëllima më zgjoji antikitetin, e gjithë dashuria poligame e Zeusit ishte me gratë e përkoishme me tokësoret... Sherifi është një dashnor me dritën, me dhimbjen dhe me përgjegjësinë. Ai nuk do as gjyq, as gjykatës; ai ka sallë gjyqi vetminë, gjykatës reflektimin e tij dhe këngë vendimmarëse të shprehurur e lirë. E fillon procesin e tij me dashurinë... Sa bukur ashtu si Jacques Prevert, që thoshte tek poezia "Dashuria":

"Kjo dashuri e tëra për ne
Nëse përsëri ngjallet
... të gjithë me diell do jemi... ajo
është e jotja,
është e imja.

Kështu ka qenë gjithmonë e re
... nuk ka ndryshuar
Ndërsa Skënder Sherifi është
më i sofistikuar, më dritëpak, sepse
mendim më thellë kur shkruan:
Të deshifrojmë bashkë me
mallëngjime

Mister i përjetshëm i
Përjetësisë etere...

Poezia e tij kumton filozofikisht. Skënder Sherifi nuk del dot nga burgu i brengave, madje as edhe nuk do që të dalë prej andej, sepse brenda tyre ai është i lirë për sa kohë flet, shprehet, këlthet, proteston dhe dëneset... Tek e fundit, kurajën t'i thotë botës je e tillë, se paku për mua. Dimensionet e tij të vetmisë dhe universit hapen si një ritmikë muzikore nga minutat zëulëta deri te korale të gjithëpërfshirëse, ku krenat e protestës shfryjnë. Ai s'ka drojë t'i thotë dashurisë se është vetëm ai që mund t'i tregojë sekretet e tokës së tij. Mes paganizmit dhe erotikës, ai është enigma. Po, po poeti është magnetizmi enigme në këtë jetë. Te shpirti tij poetik gjej Mirabon... njeriun më të vlerësuar në historinë e Francës. Skënder Sherifi e sheh si urë që lidh ku kalonjë fatet, kohët, dashuritë dhe hijet... Simbolika është shumë ndjellafrymëzuese... Mirabo... Mirë asht bo... bërë... ndaj ne kemi nevojë të shihemi... Epikuri thoshte se nuk mund të lahemi dy herë në të njëjtën vijë uji, se ai rrjedh. Edhe poezia sherifiane është e tillë, rrjedh, nuk përsërit... por që të na orientojë, na të njëjta tek ura Mirabo, atje nën hijen e



saj është poeti, ai atje vështron, mban shënime dhe shkruan për gjithësinë. Edhe ai është një urë që merr frymë, që ndërton ëndrra, që lë peng shpirtin në letër dhe që ndjehet i pajetë, por jo i vdekur sepse nuk dëgjohej. Bota moderne si në varkën e Karonit ka humbur dëgjimin, nuk do të mbajë përgjegjësi, por kjo sjellje shpinakthevise nuk e tut poetin. Sa më pëlqen një varg i tij... "Nën urën Mirabeau, e zezë, e magjepsur". Ma gjej psenë... e lexoj unë këtë fjalë, sepse poeti është i preokupuar keqas, pasi siç thotë ai, jetojmë në kohën kur me dollarë dhe me euro, shiten ide të treme. Kjo lloj jetë është një fatalitet ndryshe, i takon modernitetit kallp, përtej tri fataliteteve që shkruante Viktor Hugo... dhe quhet varrosja e mendimit në tregun e mallrave. Oh kjo gjendje e shndërron poetin në një cinik. Cinizmi i tij ka dhe nuk ka moshë. Kur poeton si simbolist, mosha e tij është relativizëm kronologjik, sepse plazmohet si parzmore estetike. Kur ai kumton si filozof, Sherifi shfaqet si hero epik, si i ardhur nga kullat e moçme të dinjitetit, ku maska është një nocion që përbuzet. Por, ironia është se bota pranon dhe do njeriun me

maskë. Këtë poeti ynë nuk e duron dot, ndaj të gjitha poezitë e këtij vëllimi janë një procedurë e heqjes së maskave. Për të mos mbetur vetëm, Sherifi lexon shpirtat dhe si një kriptolog, të gjitha personazhet e kulturës dhe historisë i shndërron falë alkemisë së tij fillimisht në këngë shpirti dhe më tej në rima, vargje dhe poezi. Si të thuash, iu krijon një tjetër jetë, krejt të pamenduar prej tyre. Kjo zhbërje-ribërje nuk është deformim, është ringjallje nga bota materiale në atë të poezisë idilike. Ky lloj konvertimi mund të quhet pa droje... "Unë të vjedh shpirtin që ai të mos humbë (a nuk e vodhi zjarrin Prometheus) dhe kështu të ta mbaj gjallë. Dua të ta mbroj nga vrasja që atij i bëjnë çdo ditë, pasi ti ishe pa sozi që të ta devijonte shënjestrën. Në këtë kuptim poezia e Skënder Sherifit mund të quhet pa mëdyshje "Muzeumi i shpirtit artistikë". Në hyrje të këtij muzeumi, që është poezia e tij, lexojmë: "Unë, Skënder Sherifi, kujdesem këtu pa pagesë!"

Jeta është një cast apo shuma e çasteve, është ajo që jetojmë, apo është iluzioni që ne përjetojmë? Kjo brenë është kudo në vargjet e autorit deri sa në një moment ai nda-

let dhe shfryn. Është tanimë në një rol të vështirë teatror. Këndon këngën e moçme sa koha që vjen nga mugëtirat, titulluar "Vajtimi i pleqve të rrënuar", kushtuar autorit francez, Fontenelle.
Çfarë mjerimi, çfarë poshtërsie mizore
nuk ka një Zot mëshirëplotë
për pleqë e shkretë në këtë botë iluzore!

Përball kësaj vetmie dhe mosinteresimi, me fletën e dënimit në duar që një ditë unë, ti, ai të gjithë do jemi pleq të braktisur, poeti sa personal dhe më shumë impersonal zhytet në jetën e pasionit dhe dëshirave që të lë të kuptosh se biografia shpirtërore e viteve '70-'80-të po vinte duke lëshuar që nga larg një aromë përcudnimit të tillë, që tregon se pasi lamë pas dashurinë, pasi humbëm mendimin dhe pasi harruam se një ditë do të jemi të harruar, nuk na mbetet gjë tjetër veçse të harbohemi.

Liria u bë e lirë dhe e pakapshme në ekstrem.

Hapësirat na u hapën, të pamundshme në ujë.

Marramendjet morën vrull, si dallgët oqeanike
e palxueshmja u bë e lexueshme, dikur në ikje!

Këto janë motive në një liri, që vetëm emrin ka të tillë, sepse ajo ka humbur gjithçka ky është kumti i poetit. Shoqëria është e sëmurë, është nën ethe, por shkenca krenohet. Shëndeti mendor i saj është në tallazi, por dikush apo disa kujdesen, veç e gjitha kjo për poetin është një shfaqje, ndaj ai ua heq maskën kur ju thotë:

Stop me teatrologjinë e Sorbonës, stinë e pa stinë
nuk jam djali i askujt, e refuzoj që sot atësinë...

Kjo lloj proteste është sa shpërthim, aq edhe përgjegjësi, është kushtrim... Teatrologjia e shkencës është një nocion shumë i patakuar. Mbese është Sherifi, ati këtij krijimi dhe bekuesi i kësaj krijese, por është një e vërtetë e madhe, e pathënë me kaq vetëflim. Por, jeta ecën, ka muzikën e vet. Edhe një shikim naiv vajzëror sërisht shpirtin ia ngroh, qoftë edhe në mënyrë të pakapshme... për dashurinë si thotë ai: "E ndez flakën dhe rrëzohet për të marrë plagën"... Skënder Sherifi shtron ndoshta pyetjen më të mençur... Shkakun e mëzisë nuk po e gjej dot? Po pse jeta duhet të bëhet kaq e komplikuar, pse njeriu duhet të shumëzohet me faktorët e kotësisë dhe të sendërtimit? Pse? A nuk ka gjëra më të thjeshta dhe më delikate, më humane dhe më të dëlira? Një dashuri e pastër të sjell gëzimin.

Në sytë e mi
ka një det pafund,
në sytë e tu
era degët i tund...

Mjaftojnë edhe këto vargje të kuptosh se sa i thjeshtë është motivi jetës... Pra, Sherifi hera-herës del nga bota e enigmave dhe goditjes së sofistikuar, është i bardhë si një djalosh që e do mirësinë si të jetë prej shpirti dhe ka një imanenc që nuk do shumë vuajtje për t'u kuptuar, ajo është dashuria e drejtpërdrejt dhe pa dredha. Edhe nëse dashuria nuk vjen, edhe nëse ikën, edhe nëse na fal gëzim, edhe nëse jo, ajo është për ne, është si ne, është ne. Ndryshe duhet të pranojmë se jemi në jetë, por jeta nuk është e jona, jemi ata që s'jemi, por nuk e dimë ende se çfarë jemi dhe çfarë nuk jemi. Mbetet të jemi pjella të relativitetit. Si shkruan poeti:

Ne jemi fëmijët e pasigurisë,
bij të një ardhmërie pa jehonë.
Edhe këto dy vargje po të kishit e gjithë libri, do ia vlenë ta lexoje dhe ta rillexoje. Çdo të thotë të jesh biri pasigurisë? Kjo është gjëmë apo mëdyshje? Jetojmë në kohën e pasigurisë, po kultura e pasigurisë dhe civilizimi me të njëjtin emër, cilët do të jenë?! E ardhmja pa jehonë do të thotë që jetojmë kohë pa shpirt dhe si e tillë, ajo nuk do shndërrohet dot në kujtesë... Eh →

Angezi është kthyer në lojtar vendimtar

Majkëll Ngo, blerja e vërtetë e Tiranës



jëherë më Ardjan Memën pikërisht për shkak të temperamentit. Dërgimi në skuadrën e dytë, bënin që rik-

thimi i tij të dukej i pamundur, e megjithatë në klub drejtuesit, pavarësisht se të bezdisur nga tekat e sulmuesit, nuk i vunë kurrë në dyshim afësitë e tij, ashtu si dhe qëndrimin në skuadër. Vendimi i drejtë, pasi me menaxhimin e duhur Ngo është rikthyer ai

që presin të gjithë: arma plus e Tiranës, që ka gjetur "bombërin" e shumëkërkuar pikërisht në shtëpinë e saj. Mund të konsiderohet pa frikë blerja e madhe e bardhebluve, edhe pse në fakt u rikthye në formacion para janarit, duke dhënë kontributin e tij.

Raporti me Memën duket i rikuperuar krejtësisht, ndërsa në fushë Ngo është i aftë të bëjë repart i vetëm. 3 golat e këtij fillimviti duken vetëm fillimi, Tiranë dhe tifozët presin ende shumë prej tij, e pa dyshim, edhe një gol në derbi.

Trajneri ka besimin e drejtuesve më të lartë zikaltër, ndaj nuk është në dyshim, për momentin

Marota mbron Spaletin dhe sulmon kapitenin Ikardi

Drejtori: Mauro? Lojtar që menaxhohet nga gruaja



Jeton Selimi

Interi po kalon një moment të vështirë në kampionat, duke qenë se përveç fitores në Kupë ndaj Beneventos, zikaltërit ende nuk e kanë shijuar fitoren në kampionat për vitin 2019. Së fundmi, ishte Bolonja ajo e cila pas më shumë se një viti, arriti të fitonte një ndeshje në transfertë pikërisht ndaj Interit. Tifozët shpesh mendojnë s'kjo ecuri vjen si shkak i problemeve jashtë fushës së blertë dhe çështjes që lidhet me rinovimin e Ikardi. Ky i fundit nuk ka shënuar në ndeshjet që Interi nuk po fiton dhe paraqitet e tij me fanellën e Interit i ka zhgënjyer tifozët. Njëpërmytet një postimi në 'Instagram', Ikardi ka marrë rolin e një futbollisti që realisht po jep maksimumin në fushë dhe në një foto ka shkruar "Nëse nuk na mbështesni kur humbasim, mos na doni as kur të fitojmë" bie në sy fakti që komentet e kësaj të limituara dhe asnjë nga tifozët e Interit, nuk mund të komentojnë".

MAROTA: SPALETI ËSHTË NË DYSHIM
Bepe Marota, administra-



tori i deleguar i Interit, komenton situatën në kampionat zikaltër, situatë aspak e mirë sidomos pas tri humbjeve radhazi. Gjithsesi, ish-drejtori i Juventusit vendos pikat mbi "I" menjëherë sa i takon çështjes së trajnerit Spaletti. "Spaletti nuk është në dyshim, pozicioni i tij është solid. Jemi në një moment vendimtar në kampionat, mungojnë 16 ndeshje. Është e vërtetë që jemi në një fazë të vështirë, por kemi një shoqëri të fortë, një grup kompetitiv dhe një trajner të aftë." Më pas, Marota flet dhe për vërshtëllimat e publikut të "San Siros" pas humbjes së fundit ndaj Bolonjës. "Vërshtëllimat janë provë dashurie kur gjërat nuk shkojnë mirë. Duhet kuptuar gjendja shpirtërore e atyre që vijnë në stadium".

GODITJA NDAJ KAPITENIT IKARDI

Duket si një hakmarrje nga argentinasi, i cili ka që në fillim të dhjetorit ja shënuar me aksion. Marota nga ana e tij nuk ka dashur të bëhet pjesë e këtyre skenareve "djallëzore" dhe për "Sky Sport" ka thënë: "Është një moment jo i mirë për të, por është normale për një sulmues që ka uljet dhe ngritjet e veta. Ai ka hapësirë për për mirësim. Gruaja e tij menaxhon aspektin e kontratës dhe vetë Ikardi duhet të qëndrojë i përqendruar dhe i fokusuar duke kontribuar te fitorja". Është e vështirë të bindësh opinionin zikaltër se kapiteni nuk po luan sepse nuk është në formë, rinovimi i kontratës ka ndikuar tek ai dhe po ndikon ende ndaj Ikardi.

VJEN JAITEH



Partizani prezanton "të fundmin e Mohikanëve"

Tijan Jaiteh është lojtar i të kuqve që më datën 31 janar, teksa rasti i tij u bë shumë i njohur për faktin se arriti të regjistrohej në sistem nga drejtuesit e kuq vetëm pak sekonda përpara se të mbyllet dritarja e transferimeve të merkatos. 30-vjeçari Jaiteh, 1.88 metra i gjatë, ka firmosur për 18 muaj me kryeqytetasi të kuq, ndërsa prezantimi i tij zyrtar është bërë vetëm pak caste më parë nga klubi i Partizanit. "Tijan Jaiteh është prezantuar sot në ambientet e klubit si lojtar më i ri Partizanit. Mesfushori nga Gambia ka mbërritur në kryeqytet dhe menjëherë i është bashkuar skuadrës në stërvitje. Jaiteh regjistron eksperiencën të suksesshme në Norvegji, Danimarkë, Slloveni, Finlandë, Izrael, Katar dhe ka nënshkruar me të kuqtë një kontratë për një vit e gjysmë. Mesfushori i cili ka qenë pjesë edhe e përfaqësueses së Gambias është një tjetër përforcim i afruar në merkaton e Janarit. #WelcomeTijanJaiteh #MirëSeErdhëNëFamiliJenEKuqëTijaniJaiteh," shkruhet në njoftimin e të kuqve.

VENDIMI

UEFA nuk e fal Mylerin, humbet Liverpul


Bajern Mynih - Liverpul është një prej sfidave më emocionuese të këtij turi të Ligës së Kampionëve, por në kapin bavarez gjërat nuk janë dhe aq pozitive në prag të 180 minutave ndaj kryesuesve të kampionatit anglez. UEFA ka rrezuar ankimmimin e Bajernit në lidhje me Tomas Mylerin, që do t'i humbasë të dyja sfidat ndaj Liverpult për shkak të një skualifikimi. Lojtari gjerman u pezullua me dy takime pas goditjes me shkelm në kokën e Taljafikos në ndeshjen e fundit në grup ndaj Ajaksit. Bajerni kishte ankimmuar vendimin e skualifikimit prej dy ndeshjesh, por UEFA ka vendosur të mos e pranojë këtë ankimmim.



KUPA E MBRETIT

Mesi rrezikon të humbasë një tjetër klasike

Në Barcelonë, të gjithë tifozët e ekipit blaugrana njanë në ankth dhe kanë të drejtë. Ylli argentinasi, Leo Messi, mund të mos jetë i gatshëm për përballjen kundër Real Madridit, sfidë e vlefshme për gjysmëfinalen e "Kupës së Mbretit". Mesi pësoi një dëmtim ndaj Valencias, një shqetësim muskular, që mund ta detyrojë asin e futbollit botëror të humbasë një tjetër sfidë ndaj rivalëve të përjetshëm pas asaj në kampionat. Mesi është stërvitur me ekipin, por trajneri Valverde mund të vendosë ta lërë në stol, pasi nuk kërkon të rrezikojë një përshkallëzim të situatës. Sfidat e parë ndaj Realit do të luhet të mërkurën.




Në tavolinë janë 70 milionë euro

Liverpuli, gati çmenduria e radhës për Insinjen

Ëndrra titull për Liverpulin është kthyer në një obse sion për tifozët dhe drejtuesit, që duan me patjetër të triumfojnë në kampionat, triumf që u mungon që prej vitit të largët 1991. Ndaj prej këte qëllim, në çdo merkato verore, klubi i kuq nuk e mban dorën në shpenzimet që bën, duke kërkuar t'i ofrojnë Jurgen Klopit kontingjentin e duhur për të rivalizuar denjësisht me "big"-ët e tjerë, sikundër Mançester Siti, Çelsi, Arsenali, Tottenham apo Mançester Junajtid. Kështu, sipas asaj që publikon italianja "La Repubblica", Liverpuli ka bërë gati 70 milionë euro për shtatshkurtrin Insinjen. 27-vjeçari është lojtari më i talentuar i Napolit dhe një shifër e tillë duket se mund të kënaqë De Laurentisën e "panopur". Insinjen menaxhohet nga Mino Raiola, i vetmi që mund t'i mbushë mendjen De Laurentisit të shesë sulmuesin e tij, që deri në këtë pikë të sezonit ka shënuar 11 gola.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Eshtë intensive në shumë barna.
8. Inicialet e Basinger aktore.
10. Alikaj aktore.
13. Eshtë edhe ai tretës.
14. Ishte muza e astronomisë.
16. Një është për të lidhur.
17. U hodhën ngë Tartar nga Zeusi.
19. Diku në qendër.
20. Gjysmë tatism.
22. Janë shemra.
25. Janë pallto ushtarësh.
27. Fillojnë titrat.
28. Një garë e gjatë.
30. Janë në modë.
32. Qarkullon në SHBA.
33. Një pjesë elementare.
35. Mund të jetë e shkencave dhe ushtarake.
38. I famshmi Pacino.
40. Inicialet e Morriconë-s.
41. Eshtë edhe ai i Zi.

- 42. Me të bëjnë tortë.
43. Vanessa violiniste.
45. Ishte lumi i harresës.
46. Një pjesë e nergjive.
47. Një markë makine amerikane.
50. I famshëm ai i mjejmave.
53. Shkruhet në korrik.
54. Janë si zakone

VERTIKAL

- 1. Ishte muz e komedisë.
2. Eshtë shkrimi me kreshnikët
3. Rastet pa set.
4. Nuk i tregohen babait.
5. Nuk lejohet një i tillë në kthesë.
6. Në fund të fundit
7. Agjenci Informative italiane.
8. Mbushen me vota.
9. Eshtë sekrete në dorë.
10. Enti italian i energjisë elektrike.
11. Kujtohen me nostalgji ato të rinisë.
12. Dy asa.
15. France shkrimtar.
18. Janë tallës.
21. Eshtë si baba.
23. Janë tituj në ekran.
24. Një konfuzion total
26. Lasgushi poet.
28. Ekstre në minifund.
29. Role pa zë.
31. Mundohen ti largojnë ekzorclistët.
33. Luarasi aktore.
34. Mund të jetë pushimi.
36. U printe hunëve.
37. Grandi këngëtare.
39. Shteti me Vientianë.
44. Ente Ndërkombëtare Humanitare.
45. Pak latinisht.
46. Ente Qëndrore Ekonomike.
48. Kufizojnë trutuarët.
49. Inicialet e Asimov.
51. Fillojnë ideologjinë.
52. Inicialet e Turgeniev.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Një sportist në pistë.
5. Philippe në një markë ore.
9. Chris këngëtar.
10. Fillojnë aksionin.
12. Ato historike përkujtohen.
14. Një vit që parashikohet.
15. Janë shkronjat e mëdha.
17. Këndohet në opera.
18. Eshtë shumë e brinjëve të katrorit.
20. Dhjetë angleze.
21. Këndohen poshtë balkonit.
22. Mbyllin një studim.
23. Eshtë shpend lagune.
24. Në radhë të parë.
26. Komisari... i Dritëro Agollit.
28. Eshtë budallaaja.
30. Janë si vegla.
32. Mund të jenë autonome të tilla.

VERTIKAL


- 34. Një ushtarak i ulët.
36. Një shok armësh.
37. Grazia Cucinotta aktore.
39. U shkrua nga Zola.
41. Kapen të parat.
42. Një pjesë e tingullit.
43. Eshtë thënie e famshme.
44. Një pjesë e parlamentit.
45. Mund të jetë ciklistik
46. Fillojnë takimin.
47. Kërkojnë talent të tilla.
1. Mund të përbëjnë një arsenal.
2. Duhet vërtetuar një e tillë.
3. Eshtë alfabeti ynë
4. Një pjesë e taktikës.
5. Janë për të rreshtur në akull
6. Ishin kapo kozakë.
7. Ishte filozof i Miletit.
8. Ndiqet nga e nënta.
11. Mund të jenë republike
12. Janë shtylla me vela
13. Kush ka do të hajë.
16. Përfshijnë edhe karotat.
19. Rotor pa zë.
21. Fillojnë sefte.
23. Eshtë aru i bardhë.
25. Eshtë libri i parë.
27. Një fjalë si tutje.
29. Një franceze.
31. Maria Remarque shkrimtar.
32. Tase e volejbollit.
33. Përplasen me gatit.
35. Kusturica regjisor.
36. Panik pa kujli.
38. Zanonë për allibi
39. King Cole i muzikës.
40. Ai dhe ajo.
42. Në krtye të trupave.
44. Fillojnë profesionin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

Completed 9x9 Sudoku grid.

Argëtim filozofik

- I madhi dhe i miri rrallë janë i njëjti njeri.
- Ai ka të gjitha virtutet që i urrej dhe asnjë prej veëve që admiroj.
-Qytetarët e shëndetshëm janë e mira më e madhe që një vend mund të ketë.
- Një pesimist shikon vështirësi në çdo mundësi; një optimist shikon mundësi në çdo vështirësi.
- I burgosuri i luftës është një njeri që përpiqet të të vrasë ty, dhe pastaj të kërkon ty të mos e vrasësh atë.
- Të gjitha gjërat e mëdha janë të thjeshta, dhe shumë prej tyre mund të shprehen me një fjalë të vetme, liri, drejtësi, ndëry, mëshirë, shpresë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

Cryptogram grid with words HAREM, PAGFAAT, ERIK, DARTAKA, NAMPERIMETER, DTGENEUNO, EKAPITALISTE, KEEPRI, LSRP, EEMAOKATEI, T BARBOR, EGT, FORD, EMILTE, HARIENI, INAT, ALEATE, KAMARE, TLT, BENESAIT.

Vertical crossword puzzle 'PËRQIJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR'. Includes words like KUNERSH, TARET, AKIRA, TERRENE, RAM, FK, MERITA, AL, PALADINE, ET, HEMATOMA, S, SETE, MINARET, ET, DOR, MINIMAL, DIOR, ANA, IROMMEL, N, TENDER, I, E, V, DEO, ER, ENET, AV, ARRATIA, I, I, UN, TRIO, NG, J, A, R, J, A, R, P, I, L, L, A, M, B, A, R, A, K, A, T, A, D, A, K, A, Z, A, N, E, T, R, A, S, E, V, A, L, E, R, O, M, A, R, A, A, T, A, P, O, L, I, F, E, M, I, I, F, P, E, R, S, E, R, I, T, E, S, I, T, O, T, E, L, E, G, O, N, I, O, P, A, R, R, E, Z, E, T, N, O, A, L, I, T, R, O, T, M, M, O, T, O, R, I, A, M, I, N, M, O, D, E, M, G, A, S, T, A, A, R, N, E, N, E, J, T, E, D, L, A, R, E, N, G, R, I, E, R, K, E, N, E, T, A, T, K, A, M, A, T, E.



Thënie të mënçura

- Edhe pse unë jam krejt i kënaqur me eksplozivet...
- Sjellja është një gjë e vogël që përbën një ndryshim të madh.
- Betejat janë fituar me masakra dhe manovra.
- Gjenerali i madh, sa më shumë që i jep përparësi manovrës, aq më pak lë vend për masakrën.

